# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com








Viti XXIII - Nr. 7588 E shtunë 14 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


Dje *në* "Deutsche Welle"

Nga MAX HOFMANN

## NATO dhe xhaxhai që nervozon



Sjellja e presidentit të SHBA-ve në samitin e NATO-s i dëmton të gjithë, në radhë të parë atë vetë, botën e jashtme, vendin e tij dhe po ashtu arritjen e qëllimeve të... Vijon në faqen 20



Fjalimi *i* Ditës

## Presidenti Meta vlerëson diplomatin Bashkim Zeneli "Mjeshtër i Madh"

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta dekoroi dje ish-deputetin dhe diplomatin e shquar shqiptar, ish-ambasadorin Bashkim Zeneli me titullin "Mjeshtër i ... Vijon në faqen 21



Kryeministri pritet nga krerët e BE

## Pakti detar me Greqinë, Rama: Nuk ka tradhtarë. Hahn: Mbyllet për dy javë

Presidenti i KE: Shqipëria, anëtare e BE-së, s'ka dyshim. Tsipras: Afër zgjidhjes për zonat ekonomike, i jep avantazhe Greqisë

Nga DARINA TANUSHI

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk deklaroi dje se nuk ka asnjë dyshim se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së. "Nuk kam dyshime që nëse Shqipëria do të vazhdojë me këtë temp reformash, do të jetë... Në faqet 2-3

PROCEDURAT PER CERTIFIKATEN E PRONESISE NE KAMEZ DHE VORE

# ALUIZNI: 710 PRONARE TE RINJ QE MARRIN TAPITE

Qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, pas ndryshimeve të fundit ligjore



*(Në foto)* Foto ilustruese

Në faqet 8-10

FLET AKTORI

## Bujar Asqeriu: Nuk më përdorin partitë, duhet një teatër i ri

Në faqen 12

DETAJET E DEKLARIMIT

## Vetingu, KPK: Gjyqtari Tom Ndreca ka fshehur pasurinë, s'deklaroi kunatin e arrestuar

Në faqen 7

VENDIMI I RI

## Përfitimi i ilaçeve, shtohet lista e atyre që merren pa recetë, kush përfiton

Në faqen 11

BLUE TOOTH

Anisa Mukaj: Kur ëndrrat bëhen realitet. Jeta, e mbushur me zhgënjime

## Flet ish-misi: Vështirësitë e jetës së një modeleje

*Nesër finalja e Kupës së Botës, Erida Bajrakutaj: Ja kush e fiton Botërorin*

Ajo është një nga vajzat më të bukura të Shqipërisë, e cila arriti pas shumë përpjekjesh të realizojë ëndrrën e saj. Anisa Mukaj, ishmisi shqiptar tashmë është pjesë e kastit të modeleve ndërkombëtare në Stamboll të Turqisë. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth"

Nga PAMELA ALIAJ

të "Gazeta Shqiptare", modelja na rrëfen prapaskenat dhe gjithë vështirësitë e jetës së një modeleje. "Të jesh modele nuk është e lehtë, është e mbushur edhe me zhgënjime… Por unë ndjehem mirë pasi ëndrrat e mija po fillojnë të prekin realitetin dhe të bëhen të prekshme," thotë Anisa. Për më tepër në intervistën e mëposhtme: Keni nisur karrierën prej pak kohësh si modele ndërkombëtare. Si ndihet tani Anisa? Po është e vërtetë... Suplement






Suplement

FLASIN KOLEGET

## Shuhet Ilia Terpini, kineasti që zbuloi Yllka Mujon dhe Matilda Makoçin

Në faqen 12

# PAKTI ME GREQINË
## REAGIMET

Marrëveshja për detin, kryeministri grek: Kanë mbetur ligji i luftës dhe kufijtë

# Tsipras: Afër zgjidhjes për zonat ekonomike, i jep avantazhe Greqisë

## "Me Ramën pranuam t'i dyfishonim përpjekjet"



Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk dhe kryeministri Edi Rama

Kryeministri grek, Aleksis Tsipras deklaroi dje, se dy çështjet më të rëndësishme që po negociojnë Athina dhe Tirana përveç zonave detare, lidhen me ligjin e luftës dhe me kufijtë. Tsipras nuk ka sqaruar më tej se çfarë nënkupton me përdorimin e termit kufij. Kryeministri grek u është referuar negociatave me Shqipërinë, gjatë një konference për shtyp pas përfundimit të samitit të NATO-s. "Është bërë një punë shumë esenciale ndërmjet dy ministrave të jashtëm, në një sërë çështjesh që rëndojnë marrëdhëniet e të dy vendeve për dekada. Jemi shumë afër zgjidhjes që ka të bëjë me delimitimin e zonave ekskluzive ekonomike (ZEE), një zgjidhje që i jep avantazhe të rëndësishme palës greke - nuk dua të hyj në detaje, por kryesisht hap rrugën për delimitimin gradual të ZEE të Greqisë, të paktën duke filluar nga perëndimi që të mundim të avancojmë edhe me vendet e tjera",-u shpreh Tsipras. Kryeministri grek u shpreh më tej: "Kemi një zhvillim pozitiv sa u përket ushtarëve grekë që humbën dhe janë varrosur në tokën shqiptare dhe ditët e ardhshme do të bëhet një ceremoni përkujtimore për ta. Dhe ne nga ana jonë kemi bërë hapa kundrejt palës shqiptare, sa i përket lejes së drejtimit të automjeteve, dhe në një sërë çështjesh të tjera, jo madhore, por të rëndësishme për marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve. Dy çështjet që kanë mbetur përveç ZEE janë ligji i luftës dhe kufijtë, për të cilat ndodhemi shumë afër zgjidhjes. Çështje që ndërsa kemi avancuar deri në një pikë shumë të rëndësishme, nuk mund të themi se i kemi finalizuar". Tsipras e cilësoi si "shumë konstruktiv", takimin që zhvilloi me kryeministrin Rama në kuadër të samitit të NATO-s. "Me homologun shqiptar ramë dakord që periudhën e ardhshme dy ministrat e Jashtëm të intensifikojnë përpjekjet e tyre, pa pasur një presion të veçantë, që të shohin se deri në ç'masë do të mund të kemi një zgjidhje pozitive sa më shpejt që të jetë e mundur", nënvizoi Tsipras. "Ka përparim të madh, - tha më tej kryeministri grek. Jemi pranë fundit, por nuk i kemi zgjidhur ende. Me Ramën pranuam t'i dyfishonim përpjekjet, e të njëjtën gjë të bëjnë edhe ministrat e Jashtëm", sqaroi ai, duke shtuar se "duam zgjidhje pozitive sa më shpejt të mundemi".




Kryeministri grek, Aleksis Tsipras

**CEREMONIA**
"Kemi një zhvillim pozitiv sa u përket ushtarëve grekë që humbën dhe janë varrosur në tokën shqiptare dhe ditët e ardhshme do të bëhet një ceremoni përkujtimore për ta. Dhe ne, nga ana jonë, kemi bërë hapa kundrejt palës shqiptare, sa i përket lejes së drejtimit të automjeteve", - tha dje, kryeministri grek.

### MEDIA GREKE

Por, artikulli në faqen "online" të gazetës "Prototema", ndër të parat që përcolli lajmin, u përqendrua te një detaj i fjalës së kreut të ekzekutivit grek, te termi "kufij" dhe një diskutim me Tiranën, gjë që sipas të përditshmes greke mbetet për t'u sqaruar. "Bëhet fjalë për një gabim gjuhësor, apo diçka tjetër?". "Prototema" ngre pyetjen nëse kjo lidhet me deklaratën e Johannes Hahnit, e cila u interpretua me shpejtësi nga mediet greke si bisedime Athinë-Tiranë për ristrukturim të kufijve, duke ngjallur reaksion të madh në vendin fqinj e duke shtyrë zë-dhënësin e Hahnit të sqaronte se Komisioneri nuk i është referuar një ndryshimi kufitar, por ZEE-së. Gazeta greke thekson se, kjo çështje është e ndryshme nga ajo e përcaktimit të Zonës Ekskluzive Ekonomike mes Greqisë dhe Shqipërisë. Aktualisht, Tirana dhe Athina janë duke negociuar vetëm për marrëveshjen e kufijve detarë.

Shoqata 'Çamëria' akuzon qeverinë për marrëveshje të papërgjegjshme

## Dritan Sejko: Shqipëria humbet me paktin detar kufijtë e varrezat




Shoqata 'Çamëria' deklaroi dje, se ligji për minoritetet, marrëveshja e pritshme për detin e kufijtë si dhe ajo e varrezave greke janë një skandal, ku Shqipëria nuk përfiton asgjë, përkundrazi vetëm humbet. Në një reagim të tij, kryetari i kësaj shoqate, Dritan Sejko tha: "Duket qartë, që grupi negociator që përfaqëson Shqipërinë, ka punuar dhe punon me komplekse të theksuara inferioriteti, ku i sheh shqiptarët dhe Shqipërinë si qytetarë dhe shtet të dorës së dytë. Shoqata 'Çamëria' dhe PDIU urojnë që ky vit të jetë viti i Skënderbeut dhe jo i Hamzait e Esad Pashës se radhës". Sipas shoqatës Çamëria, "marrëveshja e papërgjegjshme e toponimeve, e denoncuar ashpër prej vitesh nga shoqata 'Çamëria' dhe PDIU, lidhur midis Shqipërisë dhe Greqisë, e nënshkruar nga Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias, sot po del në dritë për shqiptarët. Jo më larg se dje, një nënë nga Vlora, denoncoi faktin se nuk pajisej dot me pasaportë biometrike, sepse vendlindja e saj është Arpicë, Çamëri". Shoqata 'Çamëria' dhe PDIU kanë treguar fakte të njëpasnjëshme, për marrëveshjen e papërgjegjshme të toponimeve, e cila çdo ditë po vërteton gjenocidin e ushtruar nga Greqia te shqiptarët e Çamërisë, gjenocid ky që mesa duket, po ushtrohet edhe te marrëveshjet e fshehta që nënshkruhen në dëm të të gjithë shqiptarëve, thuhet në reagim. "Pasi heshtën për çështjen çame, pasi nuk guxojnë më të përmendin Çamërinë, tani duan të mohojnë edhe vendlindjen e pleqve shqiptarë që e kanë në atë trevë krenare të shqiptarisë. Ky akt i shëmtuar nuk vjen më nga pala greke, por nga qeveria shqiptare. Një akt i paprecedent i humbjes së identitetit nga drejtuesit shtetërorë që janë zgjedhur me vota shqiptarësh dhe jo grekësh",- thuhet në reagimin e shoqatës 'Çamëria'.

### Ceremonia, varrosen 100 ushtarë grekë pa emër në Bularat të Dropullit

Eshtrat e 100 ushtarëve të paidentifikuar të gjetura gjatë gërmimeve të nisura këtë fillimvit në fushën e Dragotit në Tepelenë u vendosën këtë të premte për t'u prehur përfundimisht pranë varrezës memoriale të Bularatit në Dropull të Gjirokastrës. Ceremonia u zhvillua sipas protokollit ushtarak grek dhe riteve fetare ortodokse greke. Fillimisht u mbajt një meshë në kishë e më pas eshtrat ishin të vendosura brenda kutive metalike dhe u vendosën në pjesën murale të varrezës së Bularatit, aty ku gjenden edhe të tjerë ushtarë greke të paidentifikuar. Mes të pranishmëve ra në sy ambasadorja e Greqisë në Tiranë, Eleni Sourani, përfaqësues të Athinës zyrtare, familjarëve të viktimave të luftës italo-greke, sikurse përfaqësuesve të shoqatave helene dhe kreut të PBDNJ Vangjel Dule. Ndërkohë në fushën e Dragotit në Tepelenë zhvarrimet ushtarëve të rënë në luftën italo-greke do të vijojnë për një afat të pacaktuar, ndërsa kërki-met do të shtrihen edhe në zona të tjera të vendit mbi bazë të marrëveshjes mes qeverisë shqiptare e asaj greke. Grupet e punës janë treguar gjithmonë hermetikë në informacion, por burime konfidenciale thonë se prej shkurtit deri në korrik janë gjetur eshtrat e rreth 400 ushtarëve, 100 prej të cilëve është e pamundur të identifikohen.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### Kryeministri pritet nga krerët e BE: Të angazhuar të zgjidhim problemet me fqinjët

# Pakti detar me Greqinë, Rama: Nuk ka tradhtarë. Hahn: Mbyllet për dy javë

## Presidenti i KE: Shqipëria, anëtare e BE-së, s'ka dyshim

Darina Tanushi

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk deklaroi dje se nuk ka asnjë dyshim se Shqipëria do të bëhet anëtare e BE-së. "Nuk kam dyshime që nëse Shqipëria do të vazhdojë me këtë temp reformash, do të jetë në gjendje që të përmbushë të gjitha rezultatet e kërkuara deri në qershorin e ardhshëm, sepse vendi i Shqipërisë është në BE dhe Shqipëria do të bëhet një anëtare e BE-së. Rreth kësaj nuk ka dyshime!", deklaroi dje presidenti Tusk gjatë një konference të përbashkët në Bruksel me kryeministrin shqiptar, Edi Rama. "Është shpresa dhe dëshira ime që të gjitha forcat pro perëndimore në Shqipëri të punojnë drejt të njëjtit qëllim. Përpjekjet tuaja për të sheshuar divergjencat me Greqinë janë prova më e mirë për angazhimin e Shqipërisë ndaj BE-së dhe ndaj marrëdhënieve të mira fqinjësore", theksoi me tej Tusk. Ai zbardhi edhe bisedën me Ramën, duke thënë se ranë dakord për nevojën për të rritur përpjekjet në lidhje me çrrënjosjen e migracionit të jashtëligjshëm në Shqipëri. Nga ana e tij, kryeministri Rama tha se, "gjatë këtyre 12 muajve do të punojmë fort për të arritur rezultate të mira, me qëllim që kur të futemi formalisht në negociata, të kemi fituar kohë dhe të ecim më shpejt". Ai premtoi se qeveria shqiptare është shumë e angazhuar "ndaj zgjidhjes së problemeve të vjetra me fqinjët e jugut". Duke ju referuar asaj çfarë tha Tusk, Rama shtoi se kanë bërë progres të mirë. "Shpresoj ta përfundojmë me sukses këtë dialog të vështirë, të hapur, por të sinqertë, siç jemi të angazhuar njëkohësisht ndaj bashkëpunimit dhe stabilitetit rajonal, ku rajoni ka bërë një progres të madh, por sigurisht ka ende shumë për të bërë", tha Rama.

**TAKIMI ME HAHN**

Ndërkohë po dje, kryeministri Rama ishte në një konferencë të përbashkët edhe me Komisionerin për Zgjerimin, Johannes Hahn. Komisioneri Hahn vlerësoi: "Përfundimet e qershorit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, i miratuar nga Këshilli Europian, përbënnë një hap të madh përpara në procesin e integrimit të Shqipërisë. Tashmë kemi një rrugë të qartë që të drejton në hapjen e negociatave të integrimit midis BE-së dhe Shqipërisë në qershor të vitit 2019. Ndërkohë, procesi i reformave duhet të vijojë me një ritëm të shpejtë, ashtu siç ka ndodhur deri më tani". Ai tha se do të jetë në Tiranë të enjten që vjen për të nisur punën përgatitore për këtë. "Kjo është një ambicie sfiduese, një punë gjithëpërfshirëse, në të cilën duhet të shohim në të gjitha drejtimet që përfshihen në 35 kapitujt. Kështu procesi 'screening' është i detyrueshëm, duhet bërë dhe nga cilësia e punës, varet ritmi me të cilin do të ecin negociatat më tutje. Mendoj se gjithçka që do të bëhet në muajt në vazhdim është e rëndësishme për cilësinë dhe shpejtësinë e diskutimeve në vijim", tha Hahn. Ai u shpreh më tej se mbështet përkushtimin e kryeministrit Rama dhe qeverisë së tij, për të vazhduar përmbushjen e të gjithë objektivave thelbësore. "Pres me padurim të flas për detaje të tjera javën e ardhshme në Tiranë, duke u takuar siç thashë, përsëri me kryeministrin, qeverinë, figura të rëndësishme të administratës, por gjithashtu, nëse do të ketë kohë, do të përpiqemi të flasim edhe me opozitën. Sepse edhe një herë, flasim për një objektiv kombëtar që ka nevojë për mbështetjen e të gjithëve në shoqëri, në mënyrë që të përmbushen synimet që ndahen nga të gjithë shqiptarët. Bëhet fjalë për një qëllim të fortë, të qartë, ku të gjitha sferat e shoqërisë bëhen bashkë", theksoi Hahn.



Kryeministri Edi Rama dhe Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn

**EDI RAMA**

"Ne jemi absolutisht gati për procesin analitik dhe presim me padurim të fillojmë në të gjitha drejtimet, duke mbajtur parasysh se do të jetë një punë e vështirë dhe nevojitet të bëhen përpjekje të mëdha për të gjitha hapat", u shpreh Rama, sa i takon nisjes së punës përgatitore për negociatat.

**PAKTI ME GREQINË**

Gjatë konferencës me Hahn, kryeministri Edi Rama deklaroi se Shqipëria është pranë marrëveshjes me Greqinë. Ai atakoi opozitën në të dyja anët e kufirit kur deklaroi se ka tradhtar, por në momentin e finalizimit të marrëveshjes, ata që kanë lëshuar akuza për negociatat që po zhvillohen do të turpërohen. "Situata sikur e shohim ne të gjithë, është se ka tradhtar në qeverinë greke dhe atë shqiptare. E vërteta është që të dyja palët po gjejnë zgjidhje në interesat më të mira të popujve të tyre. Gjendja e procesit është e tillë, kemi bërë mjaft progres. Ka çështje që mbulojnë 70 vite histori, nga ligji i luftës te kufiri detar, janë të vështira dhe ne po i përballojmë me frymën e hapjes, kemi bërë progres. Hije të së kaluarës kanë dalë thesfond. Jam 100% i sigurt se kur të finalizohen rezultatet, kushdo që akuzon për tradhti nga të dy krahët do të turpërohet nga opinioni publik", tha Rama. Edhe komisioneri Hahn u shpreh se zgjidhja e probleme kufitare përshpejton negociatat e integrimit të Shqipërisë në BE, pasi në union nuk do të pranohet asnjë shtet që ka dosje të pazgjidhura. "BE nuk do të pranojë asnjë shtet që ka konflikte të pazgjidhura me vendet fqinje, kjo ka përshpejtuar negociata në disa vende, si në rastin e zgjidhjes së çështjes së emrit mes Greqisë dhe Maqedonisë apo raste të tjera. Shqipëria është në negociata me Greqinë, nuk preferoj të bëj ndonjë koment tjetër, më vjen keq që ka pasur keqkuptime. Pas dy javësh jam i bindur që do të ketë rezultate", tha Hahn.

## Samiti i NATO-s, Xhaçka: Aleanca vlerëson kontributin e Shqipërisë

Shqipëria vlerësohet për kontributin dhe angazhimin e saj në misionet dhe operacionet e mbrojtjes kolektive. Një ditë pas Samitit të NATO-s, që u mbajt në Bruksel, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka nënvizoi qëndrimin që Aleanca e Atlantikut të Veriut mbajti sa i takon Shqipërisë. "Pavarësisht se Shqipëria shpenzon 1.2% të buxhetit të saj përkundrejt PBB për NATO-n dhe ka kufizimet e saj në financa dhe kapacitete, kontributi i pakursyer i djemve dhe vajzave tona në uniformë në misionet dhe operacionet e mbrojtjes kolektive vlerësohet maksimalisht dhe u vlerësua edhe në këtë samit nga drejtuesit e Aleancës. Ky kontribut na rendit në vendin e dytë si kontributori kryesor në raport me madhësinë e Forcës së Armatosur në Afganistan, misioni kryesor i Aleancës dhe në vend të 13-të në raport me vendet e tjera anëtare për kontributet tona në të gjitha misionet e operacionet e Aleancës. Siç ka thënë edhe sekretari Mattis, Shqipëria vazhdon të dëshmojë se madhësia e saj gjeografike ka shumë më pak rëndësi se angazhimi i saj në Aleancë", - tha ministrja e Mbrojtjes. Ministrja Xhaçka mori pjesë në Takimin Special të ministrave të Mbrojtjes SHBA - Karta e Adriatikut (Shqipëri, Kroaci, Mal i Zi, Maqedoni, Bosnje dhe Hercegovinë), që u mbajt këtë të premte në Zagreb. Në takimin ku mori pjesë sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, ministrja Xhaçka propozoi zgjerimin e Kartës së Adriatikut. "Ka ardhur koha që përpara se t'i kërkojmë NATO-s të hapë dyert e veta, duhet të tregojmë se jemi të gatshëm të hapim dyert për njëri-tjetrin, pikërisht këtu në shtëpinë tonë. Shumë shpejt, A-5 do të bëhet A-6, pas ftesës që do i bëjmë Kosovës për t'u bërë anëtare me të drejta të plota dhe pse jo edhe A-7, nëse edhe Serbia do të pranojë ftesën për t'u bërë pjesë e kësaj iniciative, pararendëse për integrimin e rajonit në NATO", - deklaroi ministrja Xhaçka.






## Berisha: Rama, më i diskredituari në Samitin e NATO-s

Ish-kryeministri Sali Berisha ka sulmuar pasardhësin e tij, Edi Rama lidhur me vizitën e këtij të fundit në Samitin e NATO-s. Në një status në faqen e "Facebook"-ut, Berisha theksoi se Rama ishte më i diskredituari në Samit, pasi e uli buxhetin për NATO-n nga 2.21% në 1.1. Mes ironisë, Berisha tha se Rama bënte foto për të mashtruar publikun me takime që sipas tij nuk ndodhen kurrë. "Për të mbuluar sadopak diskreditimin e tij të plote, lëpihej dhe përpiqej të nxirrte ndonjë foto nga Samiti për të mashtruar publikun me takime që nuk ndodhën kurrë", shkruan Berisha. "Edvini ishte në Samitin e NATO-s njeriu më i diskredituar. Ai shkoi aty jo vetëm si Noriega i Europës, por edhe si njeriu që protestoi me portrete të Enver Hoxhës kundër anëtarësimit në NATO dhe uli nga 2.21% që ishin para vitit 2013, në 1.1% buxhetin për NATO-n. Në samit atij i refuzuan 7 takimet e kërkuara me liderët e 3 vendeve të tjera", tha Berisha.

# KORRUPSIONI
## AKUZAT

Lufta kundër korrupsionit, PD zbulon kontratën që nënshkroi kryeministri në Londër

# Marrëveshja në Samitin e Londrës, të gjitha angazhimet e Shqipërisë

## Tabaku: Kontrata e Ramës, fatkeqësisht një fasadë



Valentina Madani

Kryeministri Edi Rama nënshkroi dje në Samitin e Londrës një dokument në lidhje me detyrimet e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit. PD-ja përmes deputetes Jorida Tabaku publikoi dje disa pjesë të këtij dokumenti. Konkretisht, marrëveshja e vendeve në luftën kundër korrupsionit (angazhimet e Shqipërisë)(si rrjedhim i Samitit të Londrës 2016) 1). Në fushën e PPP - angazhohet që shpërndarja e informacionit të Partneritetit Publik Privat për të bashkuar qeveritë, zbatimin e ligjit, rregullatorët dhe sektorin financiar për të zbuluar, parandaluar dhe frenuar pastrimin e parave të lidhura me korrupsionin. Të ndajë informacione me shtetet e tjera lidhur me PPP-të që të sigurojë luftë efektive ndërkombëtare kundër pastrimit të parave. Të bashkëpunojë në mënyrë aktive dhe të marrë pjesë në iniciativat e rrjetit Egmont, Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare. 2) Prokurimi publik dhe kontratat e hapura. Të forcojë pavarësinë e procedurave të prokurimit publik. Të punojë në implementimin e parimeve, të Dhënave dhe Standardeve të Kontratave të Hapura duke u fokusuar në projekte të mëdha, si një prioritet i hershëm. Zbatimi i Standardeve të Hapura të të Dhënave Kontraktuese, si pjesë e punës së prokurimit të ri elektronik. Të punojë me Partneritetin e Hapur Kontraktues. Bashkimi me Partneritetin për Buxhetim të Hapur dhe angazhimi për t'u shqyrtuar sipas anketës OBP. Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku shprehet se, "kontrata që Rama ka firmosur në Samitin e Londrës është në funksion të spektaklit dhe shfaqjeve që i ka pa TVSH". "Ka firmosur në kontratë se tenderat e koncesionet e radhës do të jenë me konkurrencë të hapur, ndërkohë që aktualisht 30% e tenderave dhe koncesioneve janë pa garë dhe në kundërshtim me ligjin e i fitojnë vetëm një grusht njerëzish të lidhur me pushtetin. Qenka angazhuar se do ketë konkurrencë të lirë, ndërkohë që në programin "1 mld euro" deri më tani 4 prej 7 projekteve u kanë shkuar firmave me një ofertë të pakërkuar. Ndërkohë, pavarësia e Agjencisë se Prokurimeve Publike është inekzistente. Sistemi 'online' nuk përdoret dhe nuk është përdorur për asnjë projekt PPP", theksoi deputetja e PD-së. Sipas tabakut: "Shqiptarët nuk kanë asnjë iluzion se çdo gjë është fasadë e propagandë, fatkeqësisht këtë po e kuptojnë edhe partnerët ndërkombëtarë. Ka një dhe vetëm një pengesë për integrimin e vendimit dhe është kjo qeveri dhe Edi Rama. Asnjë kontratë formale e fasadë nuk shërben për asgjë për sa kohë realiteti është ndryshe".



Deputetja e PD-së Jorida Tabaku

**DEKLARATA**

"Shqiptarët nuk kanë asnjë iluzion se çdo gjë është fasadë e propagandë, fatkeqësisht këtë po e kuptojnë dhe partnerët ndërkombëtarë. Ka një dhe vetëm një pengesë për integrimin e vendimit dhe është kjo qeveri dhe Edi Rama", tha Tabaku.

**"Shqipëria, jo në listën e vendeve që kultivojnë kanabis"**

## Raporti i antidrogës italiane, MB: Akuzat e opozitës, me sfond politik

Akuzat e ditëve të fundit të PD dhe LSI, sipas tyre, mbi raportin vjetor të Antidrogës italiane për vitin 2017 e kanë detyruar Ministrinë e Brendshme që të reagojë publikisht. Në reagimin e shpërndarë për mediat thuhet se Shqipëria nuk është më në listën e vendeve që kultivojnë kanabis, e konfirmuar nga raporti i monitorimit ajror të Guardia di Finanza-s italiane, në fundvitin e kaluar dhe se kjo është një beteje e fituar në vitin 2017 dhe po konsolidohet në vitin në vazhdim, kur jemi në zbatim të protokollit operativ për fluturimet ajrore, duke monitoruar territorin me policinë italiane dhe asistencen e BE-së. "Siç është pranuar, 2016 ishte një vit problematik për shumë arsye, që janë bërë pjesë e analizës së punës së Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit dhe nuk rezultoi efikas në parandalimin e kultivimit të kanabisit. Por gjithsesi, nuk mund të krahasohet me përmasat shqetësuese të fenomenit përpara 2013-ës, e evidentuar në raportet GdF. Kjo solli një sasi të konsiderueshme të lëndës narkotike të gatshme për treg, në vitin pasardhës. Duke u ndalur tek raporti i Antidrogës italiane (DCSA), (faqja 35), shifra prej rreth 90 tonë kanabis evidentohet si e sekuestruar përgjatë gjithë 2017-ës në të gjithë territorin kombëtar italian dhe jo si sasi e trafikuar nga Shqipëria. Sipas raportit (faqja 36), sasia e kanabisit e kapur në tentativë për trafikim nga Shqipëria është rreth 15 tonë. Këto sasi të kapura janë fryt edhe i shkëmbimit të informacionit dhe operacioneve të përbashkëta mes Policisë italiane dhe Policisë së Shtetit, ku përgjatë vitit 2017 u realizuan 14 operacione të tilla. Në raport theksohet qartë se sasitë më të mëdha të kanabisit u tentuan të trafikoheshin nga Shqipëria, por edhe nga Greqia (faqja 23). Gjithashtu, evidentohet se kanabis në 2016-ën është kultivuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe në disa vende të tjera të Ballkanit (faqja 197). Përsa i përket përpjekjes së opozitës për t'i renditur në krye të listës shqiptarët e arrestuar në Itali për trafik kanabisi, në fakt raporti i rendit ata të pestët, ku në krye janë shtetasit italianë, marokenë etj.", thuhet në reagimin e Ministrisë së Brendshme.





**Deputeti**

**ERION BRACE**

Deputeti i PS, Erjon Braçe shprehet se rezultatet e vetingut janë dëshmi ulëritëse. Sipas tij, kriminalizimi kaq i thellë i dy gjykatave më të larta në vend duhet të ndëshkojë rëndë Partine Demokratike, përpjekjen e saj për të kapur Drejtësinë me njerëz lehtësisht të identifikueshëm si të korruptuar. Një gjë të tillë sipas Braçes, Lulzim Basha nuk e fsheh dot, pasi procesverbalet janë në Kuvend.

## Raporti i GRECO, Balla: Shqipëria, progres në luftën ndaj korrupsionit

Kreu i Grupit Parlamentar në PS-së, Taulant Balla komentoi raportin e publikuar dje nga KiE, kryer nga Grupi i Shteteve kundeër Korrupsionit (GRECO) mbi ecurinë e reformave në Shqipëri. Balla shprehet se në raport vërehet qartë progresi i bërë nga Shqipëria neë lufteën e saj kundër korrupsionit. Balla theksoi se Shqipëria ka sheënuar progres neë lufteën e saj kundër korrupsionit dhe se reforma në Drejteësi dhe vetingu i gjyqtarëve e prokurorëve po jep rezultate çdo ditë. "Në raportin e GRECO-s vlereësohet më së shumti progresi i Reformeës neë Drejtësi dhe hapat e ndeërmarra peër parandalimin e korrupsionit në radheët e gjyqtarëve dhe prokurorëve. GRECO vlerëson si mjaft të reëndeësishme pavareësineë e sistemit teë drejteësiseë, ku tashmë roli i Presidentit të Republikeës eështeë kufizuar neë emeërimin formal teë gjyqtareëve të Gjykatës së Lartë me propozimin e Keëshillit teë Lartë Gjyqësor. Zhvillim tjetër pozitiv, citohet të jetë edhe funksionimi i administratës gjyqësore, qeë sipas raportit nuk duhet teë jetë më përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, por e Këshillit të Lartë Gjyqësor", - tha z.Balla.



Akuzat e PD-së për Teatrin, Veliaj: Fatkeqësi e opozitës që drejtohet nga kalamaj

# Vokshi: Hasmëria e Ramës me Teatrin prej 20 vitesh

## "Në 98 tha se godina rrezikohej nga zjarri"



**ERION VELIAJ**

"Kur një 'politikan holandez' i thotë një arkitekti danez s'të lë të futesh në Shqipëri, i ngjan një kalamani të llastuar të një lagje tipike tironse, që nuk lë askënd të vijë nga lagjja tjetër e të luajë tek lagjja e tij",-tha Veliaj.

**ALBANA VOKSHI**

"Me zgjedhjen e Erion Veliajt në krye të Bashkisë së Tiranës, Edi Rama vendosi ekzekutimin përfundimtar të planit mafioz për shembjen e Teatrit Kombëtar dhe betonizimit të Qendrës Historike të Tiranës", deklaroi deputetja e PD-së.

Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje provat sesi hasmëria sipas saj e kryeministrit Edi Rama me Teatrin dhe artistët nuk ka lindur sot, por është 20-vjeçare. Deputetja Albana Vokshi bëri të ditur para medias sesi Rama, qëkurse u emërua ministër i Kulturës në 1998, caktoi që në fillim se godina ishte e rrezikuar nga zjarri! "Plani mafioz i Edi Ramës për të shembur Teatrin Kombëtar është një plan i hershëm dhe i mirëmenduar. Historiku që po prezantojmë sot provon se prej 20 vjetësh Edi Rama është armiku kryesor i Teatrit dhe i artistëve. Që kur ka marrë pushtet në vitin 1998, kur u bë ministër Kulture, Teatri Kombëtar dhe denigrimi i artistëve ka qenë në shënjestrën e Edi Ramës, i cili ka kryer veprime konkrete për shembjen e tij dhe betonizimin e Qendrës Historike të kryeqytetit. Me të marrë detyrën, 20 vjet më parë, Edi Rama caktoi se godina rrezikohej nga zjarri dhe urdhëroi mbylljen e sallave të shfaqjeve. Dha me qira me 1USD/m2 ambientet e Teatrit Kombëtar, i cili u kioskëzua, u kthye në bingo dhe bar kafe, duke e zhytur teatrin në borxhe për shkak të lidhjeve të paligjshme të bizneseve të Ramës brenda Teatrit",-theksoi zj.Vokshi. Ajo përmendi se: "Edhe kundërshtia e tij me Pandeli Majkon për Teatrin është 20 vjeçare, sepse ish- kryeminstri doli në krah të artistëve, të cilët kërkuan rikonstruksionin e Teatrit që, në atë kohë, sipas studimit të kryer, kushtonte vetëm 1 milionë USD. Edi Rama ministër Kulture devijoi qëllimshëm çdo fond buxhetor dhe të donatorëve të destinuar për Teatrin në projekte personale". Sipas saj plani për shembjen e teatrit ishte i mirëmenduar, që para 20 vitesh. "Këtë gjë ai e bëri edhe si Kryetar Bashkie, kohë gjatë së cilës promovoi idenë e ndërtimit me koncesion të Teatrit Kombëtar. Kjo ide e vitit 2002 dështoi për shkak të protestave të artistëve. Si kryeminstër, Edi Rama, mashtroi artistët, të cilëve u kishte premtuar para ardhjes në pushtet rikonstruksionin e plotë të Teatrit Kombëtar. Kjo jo vetëm nuk ndodhi, por ai u soll njësoj si në 1998-ën",-theksoi deputetja e PD-së.





**REAGIMI**

Kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj ka bindjen se projekti për godinën e teatrit të ri parashikon një vepër siç e quan ai spektakolare, me hapësira disa herë më të mëdha se ndërtesa ekzistuese dhe kapacitete për vënien në skenë të shfaqjeve të ndryshme. Sipas tij ky diskutim publik me zëra pro dhe kundër ndodh sa herë ka një projekt të rëndësishëm, duke e lidhur me kundërshtimet për parkun e lodrave tek Liqeni apo sheshi "Skënderbej". "Arsyeja pse teatri po sulmohet kaq shumë është e thjeshtë: e dinë që po iu fut një pune qeveria e bashkia, do ta "qajnë" atë punë, siç me këndin e lojërave te Liqeni, Parkun Olimpik, Bulevardin e Ri, Sheshin "Skënderbej", Pazarin e Ri etj. Në fakt, kjo është një përpjekje e dëshpëruar e ca kalamajve që drejtojnë sot opozitën, të cilët e dinë që teatri i ri do të jetë një vepër spektakolare, 8 herë më i madh në tokën e vet, e sigurisht, do të marrë çmime. Ata i druhen faktit që për 4 vite nuk bënë asgjë në Tiranë dhe e dinë që gjëja tjetër ku qeveria e bashkia do vërë dorë, do jetë një mrekulli. Kjo i shqetëson", tha z.Veliaj. Ai dha një përgjigje për kryetarin e opozitës, Lulzim Basha, ndaj kritikave të këtij të fundit për arkitektin danez, Bjarke Ingels, që ka bërë projektin e Teatrit të ri Kombëtar. "Jam i ndërgjegjshëm që në Tiranë ka politikanë me rezidencë në Holandë, por ama sillen si ballkanas 500 vite të prapambetur. Kur një 'politikan holandez' i thotë një arkitekti danez s'të lë të futesh në Shqipëri, i ngjan një kalamani të llastuar të një lagje tipike tironse, që nuk lë askënd të vijë nga lagjja tjetër e të luajë tek lagjja e tij. Fatkeqësi e opozitës, që ka kalamaj për drejtues, ndërkohë fat për Tiranën që është zgjuar nga gjumi, që ka një qeveri e një bashki në krye të punëve për të ecur përpara. Siç po vazhdojmë me korsitë e biçikletave, do vijojmë me teatrin e ri, me korsitë e dedikuara të autobusëve, me ndërhyrjet në Ujësjellës", theksoi kreu i bashkisë. Veliaj inspektoi dje punimet që po kryhen në Rrugën e Kavajës për shtimin e korsive të dedikuara për biçikletat.




### "Kryeministri gënjeu NATO-n për shpenzimet"

## Vasili: Takimet e Ramës me liderët e huaj, asgjë substanciale

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili pyet nëse kryeministri Edi Rama gënjeu në samit në lidhje me shpenzimet për NATO-n. Vasili tha se në prill të këtij viti Rama gënjeu median gjermane NTV kur tha se Shqipëria shpenzon 2 % të produktit të brendshëm bruto për ushtrinë. "A gënjeu prapë kryeministri për shpenzimet për NATON? Në prill, kryeministri gënjente median 'NTV'-në gjermane dhe i intervistuar prej tyre deklaronte për NATON: Pyetje 'NTV': Po në lidhje me shpenzimin e 2% të Produktit të Brendshëm Bruto në NATO dhe ndërtimin e një ushtrie evropiane? Edi Rama: Ne tashmë shpenzojmë 2% të Prodhimit tonë të Brendshëm Bruto në NATO ... Botërisht është deklaruar nga vetë ministrja e Mbrojtjes së këtij kryeministri, se Shqipëria shpenzon vetëm 1.2%. Në Samitin e fundit të NATO-s nuk dimë nëse: - kryeministri gënjeu prapë, siç gënjeu tek 'NTV' gjermane. -Apo pranoi publikisht se kishte gënjyer 'NTV' gjermane kur tha se Shqipëria shpenzonte 2% për NATON. Ose mund të mos ketë bërë asnjërën dhe ka folur për kampionatin botëror të futbollit dhe ka lyp foto, të dyja më të kollajta janë, se edhe shumë mend nuk duan, kështu që janë muhabete tamam për këtë shkollëpak që kemi kryeministër", shkruan Vasili në 'Facebook'.



### Reforma në administratë do të ndihmojë hapjen e negociatave për anëtarësim në BE

# Mesi: Ristrukturim i pagave në bazë të performancës

## *Trajnohen 15 punonjës për përmirësimin e sistemit*

Ornela Manjani

Reforma në administratën publike është një nga pikat kyçe, e cila do të ndihmojë në menaxhimin e negociatave për anëtarësim në BE. Në këtë kuadër janë përzgjedhur dhe trajnuar për pesë muaj rresht 15 punonjës civil për të ofruar shërbim sipas standardeve europiane. Zëvendëskryeministrja Senida Mesi, e pranishme në ceremoninë e diplomimit të këtyre punonjësve, u shpreh se janë të vendosur që të reformojnë administratën. Në këtë kuadër referuar edhe fondeve të BE-së do të bëhet ristrukturimi i pagave në bazë të performancës së punonjësve. Stephen Stork, shef i operacioneve, ka vlerësuar angazhimin për përmirësimin e shërbimeve të administratës, pasi objektivat e Shqipërisë janë një target në lëvizje, drejt BE-së. Pjesëmarrësit e përzgjedhur për trajnimin ishin nga katër fusha që mbulojnë politikat publike, monitorimin dhe zbatimin e strategjisë, hartimin e legjislacionit, integrimin europian dhe planifikimin e buxhetit e menaxhimit financiar. Grupi u trajnua në Shkollën Franceze të Administratës Publike në Paris dhe Strasburg.


Zëvendëskryeministrja Senida Mesi

**PREZANTIMI**

Zëvendëskryeministrja Senida Mesi prezantoi dje modelin e ri të nëpunësit civil në administratën publike në Shqipëri gjatë ceremonisë së diplomimit të 15 nëpunësve të rinj civil, të cilët ishin pjesë e një kursi studimi në Shkollën Franceze të Administratës Publike (ENA) në Paris dhe Strasburg, si dhe kanë zhvilluar vizita studimore në institucionet evropiane në Luksemburg dhe Bruksel. Në fjalën e saj, Mesi u shpreh se nëpunësit e diplomuar përfaqësojnë një model të ri të nëpunësit të administratës publike bazuar në modelet e praktikat më të mira evropiane sikurse është edhe Shkolla Franceze ENA. Në kuadër të reformës rrënjësore dhe gjithëpërfshirëse të administratës publike - si një prioritet madhor i Shqipërisë drejt integrimit evropian - qeveria Shqiptare dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë bashkuar forcat për ta shndërruar administratën publike në Shqipëri. "Era e ndryshimit në administratën publike ka filluar dhe të rinjtë e diplomuar në ENA janë ogur i mirë i transformimit të saj", deklaroi zëvendëskryeministrja Mesi, duke theksuar se modeli i ri i vlerave në administratën publike bazohet në integritet, profesionalizëm e meritokraci dhe se do t'i jepet fund njëherë e mirë mentalitetit se puna në shtet "do të thotë rehati". Mesi nënvizoi gjithashtu se po thellohet reforma duke përgatitur të rinjtë në shkollat më të mira evropiane për administratën publike dhe ftoi të rinjtë e diplomuar në Shqipëri dhe jashtë saj t'i bashkohen sfidës së qeverisë shqiptare për një administratë publike të qëndrueshme, të depolitizuar dhe me profesionalizëm të lartë. Ajo garantoi se qeveria po punon fort për të ofruar edhe më shumë hapësira angazhimi për të rinj e të reja me dëshirë për punë.

**TRAJNIMI**

Pjesëmarrësit e përzgjedhur për trajnimin ishin nga katër fusha që mbulojnë politikat publike, monitorimin dhe zbatimin e strategjisë, hartimin e legjislacionit, integrimin europian dhe planifikimin e buxhetit e menaxhimit financiar. Grupi u trajnua në Shkollën Franceze të Administratës Publike në Paris dhe Strasburg.

**TRAJNIMI**

Një grup prej 15 nëpunësish civilë nga institucionet e administratës qendrore u zgjodhën për të qenë pjesë e skemës pilot, e cila zgjati plot 4.5 muaj. Pjesëmarrësit u zgjodhën nga katër fusha kryesore horizontale që mbulojnë politikat publike; monitorimin dhe zbatimin e strategjisë; hartimin e legjislacionit; integrimin evropian dhe planifikimin e buxhetit e menaxhimin financiar. Grupi u trajnua në Shkollën Franceze të Administratës Publike (ENA) në Paris dhe Strasburg, duke përfshirë edhe dy vizita studimore në Luksemburg dhe Bruksel. Programi i trajnimit përmbajti një varietet modulesh, të cilat mbuluan tema të lidhura me politikat publike, qeverisjen për qytetarët dhe integrimin evropian. Programi i trajnimit përfundoi në qershor 2018 dhe të trajnuarit priten të sjellin në institucionet e tyre aftësi dhe energji të reja.

### Operatori blen 22 mijë sahate elektronikë

## OSHEE, kërkohet sistem i ri faturimi me matje periodike mujore

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka finalizuar blerjen e rreth 22 mijë matësve të rinj elektronikë. Oferta fituese është shpallur ajo e shoqërisë "Ital-Projekt" prej 191.4 milionë lekësh, skualifikimit të tre operatorëve të tjerë ekonomikë në garë. Kjo ishte edhe oferta më e lartë në garë, nga një fond limit në dispozicion prej rreth 200 milionë lekësh. Ndërkohë, Kuvendi i Shqipërisë, gjatë analizës së veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë, ka kërkuar përmes një rezolute nxitjen e OSHEE për vënien sa më shpejt në punë të një sistemi të ri të faturimit. Sipas deputetëve, ky sistem do të lehtësojë në mënyrë të ndjeshme matjen e energjisë, duke krijuar edhe mundësinë e matjeve periodike disa mujore. Matësit e rinj të sapoblerë nga OSHEE ofrojnë opsionin e leximit të sahatit nga ofruesi i shërbimit, pa pasur nevojë të dërgojnë një faturist në terren. Kjo bëhet përmes lidhjes me portën e rrjetit dhe të dhënat nga çdo matës dërgohen automatikisht çdo 15 minuta. Kjo mund të jetë një prej mënyrave për leximin e sahateve që kërkon Kuvendi në sistemin e ri. Ndërkohë, deri në pajisjen e të gjithë abonentëve familjarë apo privatë me këta lloj matësish, mund të zbatohet leximi i sahatit një herë në 3 muaj. Fatura për dy muajt e parë mund të bazohet mbi mesataret e konsumit të atyre muajve gjatë viteve të mëparshëm, ndërsa në muajin e tretë do të zbritet apo shtohet detyrimi i konsumatorit mbi energjinë e konsumuar.

### Raporti i Bankës Botërore

## Biznesit të vogël nuk i miratohet kredia

Edhe pse në Shqipëri, 99% e bizneseve janë ndërmarrje të vogla e të mesme, pjesa më e madhe e tyre e kanë të pamundur që të marrin kredi. Një vrojtim i bërë nga Banka Botërore zbulon se Shqipëria është një nga vendet me përqindjen më të ulët në rajon sa i përket aksesit të biznesit të vogël për të marrë kredi. 66% e sipërmarrësve që kanë kërkuar hua në bankë janë refuzuar dhe vetëm 20% e bizneseve të mesme e të vogla kanë një kredi formale. "Vetëm 17 përqind e bizneseve të vogla shqiptare besojnë se nuk ka pengesa për marrjen e një kredie, një numër dukshëm më i ulët se në ekonomitë e tjera të ngjashme", thotë raporti. Raporti hedh një pjesë të përgjegjësisë edhe në politikat e ndjekura nga qeveria, të cilat duhet të




ishin të një linje e jo si rasti i aksionit antiinformalitet, e më pas falje taksash. "Qeveria duhet të vazhdojë të zbatojë masa të balancuara me kujdes, që sigurojnë kontrollet dhe stimujt e duhur duke minimizuar rrezikun moral të krijuar nga falja e taksapaguesve"-thuhet në raport. Në Sondazhin e Ndërmarrjeve të Bankës Botërore rezulton se biznesi i vogël është i detyruar të lerë një kolateral deri në 3 herë më të lartë se shuma që merr kredi. Por edhe pse shteti e BERZH kanë akorduar një shumë prej 300 milionë euro për të garantuar kreditë në sektorin bujqësor, kjo degë e ekonomisë vijon të mbetet me financimin më të ulët. "Shumica e ndërmarrjeve bujqësore që kanë aplikuar për një kredi në vitin 2017 i është refuzuar",- përfundon raporti.

**Përmbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli,** njofton shpalljen për shitje në ankand të parë për pasuritë e paluajtshme si më poshtë;
- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7'549'200 Lekë.
- Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-31, fq.-235, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7'549'200 Lekë.
- Pasuria Nr.211/11, Vol.- 4, fq.-201, Z.k-1791, lloji Tokë-0Arë me Sip.- 500 m2, ndodhur në Golem Kavajë, me vlerë 400'000 Lekë.

**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 12.07.2018,në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë;**
**Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email; medar.kajolli@yahoo.com**

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service" me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 07.08.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i II per shitjen e pasurise te paluajtshme Truall me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtesë me sipërfaqe 128 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlere fillestare ne ankand 90,048 (Nentedhjete mije e dyzet e tete) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**Shitje me Ankand te Pare nga Studio Permbarimore L.D.C**

*-Apartamenti me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m2, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane.* **Çmimi fillestar per shitje eshte 6.413.792 Leke.**
Data e shpalljes **27.06.2018**
Data e zhvillimit **20.07.2018 deri ne oren 16.00**
Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga “Myslym Shyri” Vila 8/1, kati 1 Tirane.

# Ish-kryebashkiaku Elvis Rroshi i shpëton burgut, gjykata e dënon me 60 orë punë në komunitet

**TIRANË** - Ish-kryetari i Bashkisë së Kavajës, Elvis Rroshi, i akuzuar për falsifikim të formularit të dekriminalizimit i ka shpëtuar dënimit me burg. Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës e ka dënuar atë me 60 orë pune në interes publik. Gjykata e dënoi Roshin në krye të herës me 7 muaj e 15 ditë burgim. Për shkak se përfitoi nga gjykimi i shkurtuar, dënimi u ul në 5 muaj, po duke pasur parasysh që ai kishte qëndruar katër muaj në "arrest shtëpie", masa e dënimit që mbeti për të vuajtur ishte vetëm 1 muaj burgim dhe në fund dënimi u pezullua, duke u konvertuar në 60 orë punë publike të detyruar. Vendi dhe koha se ku ta shlyejë dënimin ish-kryebashkiaku do të përcaktohet nga Zyra e Shërbimit të Provës në Tiranë, në varësi të rrethanave familjare të të pandehurit, për shkak se ai ka fëmijë të vegjël në ngarkim. Sipas verdiktit të gjykatës, Roshi nuk duhet të shoqërohet me persona të dënuar. Elvis Roshi, i pranishëm në proces, nuk dha shpjegime dhe as bëri ndonjë koment për mediat, pasi zgjodhi të largohej nga dera dytësore e gjykatës. Roshi u vu në ndjekje penale dhe tashmë u dënua, pasi fshehu rekordet kriminale në Itali, Gjermani e Zvicër. Nga drejtësia italiane ai rezulton të jetë dënuar me një vit e katër muaj për veprën penale të përdhunimit në grup dhe dëbuar me forcë pas nga territori, pasi kishte shkelur urdhërimin e gjykatës. Prokuroria tha se Roshi ka fshehur edhe faktin se ka përdorur shtatë emra të ndryshëm. Në Gjermani e Zvicër, ai rezulton të jetë problem, por autoritetet s'u janë përgjigjur letërporosive të dërguara nga Shqipëria, duke mos sqaruar se çfarë veprash penale ka konsumuar Roshi në territorin e tyre. Por janë mjaftuar vetëm duke iu përcjellë shenjat e gishtërinjve të tij që i janë marrë kur është shoqëruar nga forcat policore atje.


Ish-kryetari i Bashkisë së Kavajës, Elvis Rroshi

Në 7 vite bleu 4 shtëpi, gjykatësi i "21 janarit": Burimi, pagat e kursimet

# Vetingu, KPK: Gjyqtari i Lartë, Tom Ndreca ka fshehur pasurinë

## "S'deklaroi në DSIK kunatin e arrestuar për drogë"

**TIRANË**

Anëtari i Gjykatës së Lartë, Tom Ndreca, një ndër emrat më të lakuar të drejtësisë shqiptare, dje është përballur me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili përfaqësohet në këtë proces nga Brunilda Bekteshi, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Ndreca ishte vetë i pranishëm gjatë seancës dëgjimore, ndërkohë që përfaqësohej edhe nga avokatja e tij, Mine Progonati. Sipas KPK, ai nuk justifikon pasurinë e katërfishuar ndër vite, ndërsa nuk ka deklaruar dënimin e kunatit për prodhim dhe shitje narkotikësh. Komisioni bëri me dije se nga hetimi i thelluar administrativ, rezulton se gjykatësi i karrierës konsiderohet i papërshtatshëm për të vijuar detyrën, pasi kishte kontakte të papërshtatshme me një person që në këndvështrimin e trupës gjykuese hyn në rrethin e atyre që konsiderohen sipas ligjit të përfshirë në krim të organizuar. Bëhet fjalë për kunatin e tij, i cili në vitin 2011 është arrestuar me gjysmë grami hashash, ndërsa në një banesë të braktisur është gjetur një sasi tjetër hashashi, por që ka rezultuar se nuk ishte e tij.

**PASURIA**

Hetimi administrativ për Ndrecën ka përfshirë kriterin e pasurisë dhe pastërtisë së figurës. Sipas KPK, deklarimi i pasurisë i bërë nga gjyqtari i lartë, Tom Ndreca është i pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare. "Hetimi paraprak administrativ përfshiu një apartament 120 m2 e garazh 18 m2 te rruga 'Muhamet Gjollesha', blerë në vitin 2003 për 2.4 mln lekë me burim krijimi të ardhurat nga paga, shitja e një apartamenti në Rrëshen dhe ndihma nga motrat dhe vëllezërit. Apartament 74 m2 në Golem, blerë në 2009-ën për 31 mijë euro me burim të ardhurat e familjes. Apartament 92 m2 te Komuna e Parisit, blerë në 2015-ën për 6 milionë lekë të ardhura nga paga. Automjet tip 'Golf', blerë nga e shoqja për 200 mijë lekë në 2012-ën me burim pagat. Depozitë bankare në emër të gruas 3 milionë lekë me kursime nga paga. Depozite personale në emër të djalit 1 milion lekë me kursime nga paga. Llogari rrjedhëse në emër të gjyqtarit 1.2 milionë lekë me kursime nga paga. Të ardhura kesh 1.5 milionë lekë nga paga". Relatorja tha: "Subjekti nuk ka deklaruar likuiditetet e gruas 1.5 milionë lekë në bankë për 2016-ën. Automjet në emër të djalit në vitin 2005. Shtesë likuiditeti 1.5 milionë lekë në vitin 2006. Në deklaratën për veting subjekti nuk ka deklaruar pasuritë: likuiditete në tri llogari në emër të gruas e dy djemve në shumën totale 113 mijë lekë. Autoveturë tjetër në emër të djalit. Bashkëshortja dhe dy fëmijët kanë deklaruar se nuk disponojnë pasuri, ndërkohë që ky fakt nuk është i vërtetë. Ata kanë pasur detyrim që t'i plotësojnë dhe deklarojnë këto pasuri, edhe pse jo në shumë të konsiderueshme. Në përfundim KPK vlerëson se deklarimi është i pasaktë për zotin Ndreca dhe jo në përputhje me ligjin".

**PASTËRTIA E FIGURËS**

Lidhur me pastërtinë e figurës, DSIK ka konstatuar përshtatshmëri për Tom Ndrecën. Hetimi paraprak administrativ ka rezultuar se më dt 11.7.2012. është lidhur një kontratë shitje automjeti mes shtetasit N.Gj. dhe motrës së tij, blerëses, gruas së Ndrecës. N.Gj. është kunati i Tom Ndrecës dhe është anëtar i familjes dhe për shitjen e mjetit hyn në rrethin e personave të lidhur. Për shtetasin N.Gj. ka pasur informacione se ka precedentë penalë. Ai është arrestuar më 9.11.2011 dhe është liruar më 5.12.2011, i hetuar për prodhim dhe shitje narkotikësh. Prokuroria e Shkodrës ka marrë vendim për pushim të hetimeve dhe rezulton 0.4 gr kanabis në mjetin e tij ishte për konsum vetjak. Ndërsa 6 kg kanabis të gjetura në shtëpinë e tij nuk është vërtetuar se janë futur aty nga personi nën hetim (ka argumentuar prokuroria e Shkodrës). KPK vlerëson se Tom Ndreca duhet ta kishte deklaruar kunatin N.Gj. në formularin e DSIK. Ai e ka fshehur këtë fakt. KPK vlerëson se Tom Ndreca ka kontakte të papërshtatshme dhe është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Ndërkaq, në hetimin administrativ, Ndreca ka deklaruar se e ka ditur faktin që kunati është arrestuar pasi është kapur me kanabis, por tha se "nuk kam pasur dijeni se çfarë është bërë me hetimet e tij deri sa jam njohur me pushimin e tyre. Nuk kam pasur qëllim ta fsheh këtë fakt". Në përfundim, komisioni tha se ndaj gjykatësit janë paraqitur 11 ankesa, por kanë rezultuar të pabazuara. Vendimi për të pritet të shpallet me datë 17 korrik.


Anëtari i Gjykatës së Lartë, Tom Ndreca

**GJYQTARI**

Tom Ndreca është bërë anëtar i Gjykatës së Lartë me propozim të presidentit Nishani dhe ka gjykuar dosjen e "21 janarit". Ai u bë i njohur në vitin 2011 (ndonëse ka qenë anëtar i Gjykatës së Apelit të Tiranës për 20 vjet), kur në cilësinë e kryesuesit në Kolegjin Penal i dha fitoren Lulzim Bashës, i cili garonte përballë kryeministrit aktual Edi Rama, për kryetar të Bashkisë Tiranë.

**ANALIZA E PASURISË**

Të dhënat e analizuara nga BIRN tregojnë se Ndreca zotëronte një pasuri familjare me vlerë 5.7 milionë lekë në vitin 2003. Referuar deklarimit të tij të parë, ai zotëronte dy apartamente banimi në Tiranë si dhe një automjet. Në fund të vitit 2017, pasuria e subjektit rezulton e rritur me 4 herë, duke kapur vlerën e rreth 22.8 mln lekëve. Nga dy apartamente që deklaronte në 2003-in, në fund të 2017-ës ai zotëron familjarisht 4 apartamente të blera kryesisht me kursime.

## SHKURT

### Ndalohen 9 aktivistë të lëvizjes "Republika e Çamërisë"

**SARANDË** - Nëntë persona, aktivistë të së ashtuquajturës "Republika e Çamërisë", janë ndaluar dje nga policia e Sarandës. Ata do të procedohen në gjendje të lirë për veprat penale "Krijim i partive dhe shoqatave antikushtetuese" dhe "Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese". Në momentin e ndalimit ka rezultuar se njëri prej tyre ka qenë person në kërkim, për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Bëhet fjalë për Ilir Berishën nga Kosova. Ai është kapur tek vendi i quajtur "Axhensia" në Sarandë, teksa ndodhej në një zyrë të kësaj organizate. Policia ka zbuluar se tek kjo zyrë vidhej energjia elektrike dhe për këtë është proceduar penalisht një prej 9 të ndaluarve si pjesë e organizatës "Republika e Çamërisë".

### U dënua me 17 vjet burg në Itali, bie në pranga 52-vjeçari

**VLORË** - Policia e Vlorës ka vënë në pranga një 52-vjeçar të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane dhe i dënuar me 17 vite burg. Bëhet fjalë për shtetasin Maks Merkaj, banues në lagjen "10 Korriku" të qytetit bregdetar. Sipas policisë, Gjykata e Assizes, Venecia, Itali, me vendimin nr. 1/2001 R.G.C.Ass, datë 10.04.2011, e ka dënuar Merkajn me 17 vite burgim (mbetur për të vuajtur edhe 14 vite) për veprat penale "Organizatë kriminale", "Pengmarrje", "Marrëdhënie seksuale me dhunë" dhe "Shfrytëzim prostitucioni". Interpol Tirana po vijon procedurat e mëtejshme për ekstradimin e këtij shtetasi drejtim drejtësisë italiane.

### Mashtronin qytetarët, lihen në burg avokati dhe polici

**DURRËS** - Gjykata e Durrësit ka vendosur dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për avokatin Devis Qana dhe efektivin e policisë Haki Dyli, të cilët akuzohen se iu merrnin qytetarëve nga 2 mijë euro duke i mashtruar se do ndikonin në favor të tyre në çështje gjyqësore. Mësohet se seanca është zhvilluar me dyer të mbyllura dhe mediat kanë mësuar pak detaje nga gjyqi. Por në fund, trupa gjykuese ka vendosur t'i lërë në burg si avokatin e Dhomës së Avokatisë në Tiranë, ashtu edhe punonjësin e policisë Haki Dyli, caktuar me detyrë shërbimi në sigurinë e godinës së gjykatës Durrës. Ata u arrestuan nga SHÇBA pak ditë më parë për llogari të procedimit penal të nisur mbi bazën e kallëzimit të kryetares së gjykatës, znj. Joana Qeleshi.

Procedurat për certifikatën e pronësisë ndiqen nga "Agjencia"

# ALUIZNI: 710 personat që kanë gati lejet e legalizimeve

## *Lista me pronarët në qarkun e Kamzës dhe Vorës*

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 710 personat që kanë gati lejen e legalizimit në Vorë dhe Kamzë. Përfituesit duhet të tërheqin lejen e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkese me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

## PERSONAT QË KANË GATI LEJET E LEGALIZIMEVE

| NR | EMER | ATESI | MBIEMER | BASHKIA |
|---|---|---|---|---|
| 1 | DED | PREK | SIMONAJ | KAMEZ |
| 2 | NAZMI BARIE | HALIL ISMAIL | LICA | PASKUQAN |
| 3 | LODOVIK | PREND | PRENDI | KAMEZ |
| 4 | HYSNI | RAMADAN | METALIA | KAMEZ |
| 5 | PELLUMB | SELIM | GJOKA | VORE |
| 6 | SELMAN | SELIM | GJOKA | VORE |
| 7 | ZOJE | ALI | MUCA | PASKUQAN |
| 8 | BESMIR | RAMIZ | GOJANI | PASKUQAN |
| 9 | ABAZ | HASANC | CENAJ | PASKUQAN |
| 10 | EQEREM | FERAT | QOSE | KAMEZ |
| 11 | HEKURAN | ISAK | SULAJ | BERXULLE |
| 12 | PETRIT | TOM | MARKU | KAMEZ |
| 13 | AVDULLA | QAZIM | DOCI | PASKUQAN |
| 14 | FERIK | DYLBER | HOXHALLARI | PASKUQAN |
| 15 | BLERIM GUZIM | AHMET | KORTOCI | KAMEZ |
| 16 | XHELAL | ASLLAN | GJUTA | KAMEZ |
| 17 | AGRON | ABDI | NDREU | PASKUQAN |
| 18 | VELI AFERDITA | ISUF RAMAZAN | CANI | KAMEZ |
| 19 | KUJTIM | FRAN | DELIA | KAMEZ |
| 20 | ABDULLA GAZMIR | HASAN | GEGA | ZALL-MNER |
| 21 | FLORI | HAMDI | REXHMATI | KAMEZ |
| 22 | ZYHRA | XHEMALI | MULLAHI | PREZE |
| 23 | HASAN | HAMDI | HOXHA | BULCESH |
| 24 | SALI | OSMAN | MUCA | VORE |
| 25 | RESHIT | RAMIZ | KOSTURI | PASKUQAN |
| 26 | MUSTAF | ALI | RROKOMANI | KAMEZ |
| 27 | ALI | RRAHMAN | PRENCI | KAMEZ |
| 28 | INDRIT | SULEJMAN | PICARI | VORE |
| 29 | FLAMUR | SHEFKI | CERAKU | KAMEZ |
| 30 | MERSIN | MUHARREM | LOKA | PASKUQAN |
| 31 | MARK | SHAN | MARTINI | KAMEZ |
| 32 | ILIR | HASHIM | MEMA | PREZE |
| 33 | FADIL | ISEN | LALA | PASKUQAN |
| 34 | RUFAT | SAFAT | LAMA | KAMEZ |
| 35 | DALIP | RAMAZAN | KONI | VORE |
| 36 | ARBEN | RAMAZAN | KONI | VORE |
| 37 | AFRIM | ALI | CERAKU | KAMEZ |
| 38 | SHERIF | RIZA | GJANA | KAMEZ |
| 39 | HAJRI | NAZIF | VISHA | PASKUQAN |
| 40 | SHEFQET | SHUAIP | KRASNIQI | PREZE |
| 41 | HASAN | XHEMALI | HALILI | PREZE |
| 42 | XHEMAL | ARIF | LIKA | KAMEZ |
| 43 | YLBER | DAUT | XHECUKA | KAMEZ |
| 44 | PETRIT | HASAN | TOTA | PASKUQAN |
| 45 | HALIT | MEHMET | BUCI | KAMEZ |
| 46 | NIKOLL TOME | MIRASH | QOKAJ | KAMEZ |
| 47 | LEONARD,MAKSIM | MEHMET | XHURA | KAMEZ |
| 48 | XHEVAHIR | ZYDI | MUHADRI | PREZE |
| 49 | RUZHDI | SEFER | VEIZI | PREZE |
| 50 | AGIM | ASLLAN | BIBA | KAMEZ |
| 51 | MARIGLENT | LULZIM | CIKU | PREZE |
| 52 | NOKE | GJIN | KABALI | PASKUQAN |
| 53 | SHKELQIM | ALI | BRUCI | KAMEZ |
| 54 | HALIM | MUS | HASA | PASKUQAN |
| 55 | DASHAMIR | TAHIR | LESHI | PASKUQAN |
| 56 | VEHBI | XHELAL | BECI | PASKUQAN |
| 57 | ISLAM | TAFIL | HASALAMAJ | PASKUQAN |
| 58 | JURGEN | MENTOR | MUGLICA | PASKUQAN |
| 59 | ABDYL | RRAHIM | ALIAJ | PASKUQAN |
| 60 | HALIL | ISUF | DOKU | KAMEZ |
| 61 | DEFRIM | RAKIP | CAMI | KAMEZ |
| 62 | FERIT | HASAN | TOTA | PASKUQAN |
| 63 | ELMAZ | HYSEN | MANALLARI | PASKUQAN |
| 64 | MALSOR | AQIF | JATA | PASKUQAN |
| 65 | SHKURTE | NIMAN | SULAJ | KAMEZ |
| 66 | GEZIM | RIZA | CANAMATI | KAMEZ |
| 67 | FLORIJE | BAJRAM | HAJDINI | KAMEZ |
| 68 | MUSTAF | RAM | DEMNUSHAJ | KAMEZ |
| 69 | MIFTAR | FETAH | BRESA | KAMEZ |
| 70 | MEHMET | MIFTAR | XHURA | KAMEZ |
| 71 | ASTRIT | BAJRAM | METALIA | KAMEZ |
| 72 | BUJAR | OSMAN | KURTI | PREZE |
| 73 | FATBARDH | FADIL | HOXHA | KAMEZ |
| 74 | QAMIL | XHAFER | BRESA | BERXULLE |
| 75 | ARTAN | ALI | IMAMI | PREZE |
| 76 | MYFTAR | UKE | PREGZAJ | KAMEZ |
| 77 | MARIE ARTAN | JAK | MARKU | KAMEZ |
| 78 | ABDULLA | BESIM | HOXHA | PASKUQAN |
| 79 | SKENDER DESHIRA | ZAIM | DAKU | PASKUQAN |
| 80 | BEDRIJE | ISLAM | DACI | KAMEZ |
| 81 | FEHMI | XHELAL | HODA | KAMEZ |
| 82 | ASTRIT | HAZIS | SUCI | KAMEZ |
| 83 | URIM | DEMIR | GJOKA | KAMEZ |
| 84 | MELIHA | ALI | PUPA | PREZE |
| 85 | ALKETA ERMEN | SHABAN NESTRE | FEZOLLARI | PASKUQAN |
| 86 | ARTUR AGRON | FILIP | MALETAJ | KAMEZ |
| 87 | ARDIJAN | GANI | CIKU | PREZE |
| 88 | KURTISH | SEJDI | DURAKU | PASKUQAN |
| 89 | BEQIR | ISNI | MIKLI | KAMEZ |
| 90 | MURAT | SALI | MENA | KAMEZ |
| 91 | SKENDER | ELEZ | PIRA | PASKUQAN |
| 92 | HAJREDIN | IBRAHIM | BEGU | KAMEZ |
| 93 | XHEMAL | DELI | CELAMI | KAMEZ |
| 94 | HYSNI | RAMADAN | METALIA | KAMEZ |
| 95 | RASIM | SHABAN | GJIKA | KAMEZ |
| 96 | LUTFI | ZENEL | HASI | KAMEZ |
| 97 | AGRON | HALIM | AHMETI | KAMEZ |
| 98 | YLLKA | SHERIF | NABOLLI | KAMEZ |
| 99 | HASAN | AHMET | BRAHAJ | KAMEZ |
| 100 | AHMET | PETRIT | AXHA | PREZE |
| 101 | SAIMIR | EMERLLA | KOVACI | PREZE |
| 102 | ARIF | METUSH | ISLAMIU | PASKUQAN |
| 103 | MUNIR | ESHREF | KRRACI | PREZE |
| 104 | RREMZI | ELMAZ | SULA | KAMEZ |
| 105 | AGRON | ABDYK | KAZIU | PREZE |
| 106 | GEZIM | SKENDER | VATA | PASKUQAN |
| 107 | YLLI | FADIL | MEZINI | PREZE |
| 108 | SAMI | XHAFER | KULLI | PREZE |
| 109 | AQIF | RAMAZAN | HASKURTI | PASKUQAN |
| 110 | BAFTJAR ASTRIT | SELIM BAFTIAR | MANDRI | PASKUQAN |
| 111 | ARDIAN | ABAZ | KURTI | KAMEZ |
| 112 | MAJLINDA | SHAIP | LALA | PASKUQAN |
| 113 | PAULIN PLATON | VIKTOR | LECI | KAMEZ |
| 114 | IBRAHIM | XHEZAGIR | AXHAMI | KAMEZ |
| 115 | NDRICIM | ZENEL | PEPOSHI | PASKUQAN |
| 116 | NEKI | FERIT | CAMI | KAMEZ |
| 117 | KOL GASPER | PASHK KOL | HAXHIJA | KAMEZ |
| 118 | TONE | ZEF | PJETERGJOKA | KAMEZ |
| 119 | BAJRAM | SHEMSI | ZYBERAJ | PREZE |
| 120 | BEHAR | QAMIL | BASHA | KAMEZ |
| 121 | SHERIF | SEKMAN | NOKA | PASKUQAN |
| 122 | HYSNI | HYSEN | SKANA | KAMEZ |
| 123 | EMIN DILAVER | HAQIF | QINAMI | KAMEZ |
| 124 | METAT | LAVDRIM | MANDRI | PASKUQAN |
| 125 | HASAN | SHAQIR | BARA | KAMEZ |
| 126 | SULEJMAN | MERSIM | DUDA | PASKUQAN |
| 127 | SHPETIM | LIMAN | DISHA | PASKUQAN |
| 128 | MENTOR | TEFIK | KALLJA | PASKUQAN |
| 129 | LAZAM | SELIM | LALA | KAMEZ |
| 130 | ISTREF | BAJRAM | ZYBERAJ | PASKUQAN |
| 131 | JETMIR ISLAM | QAZIM | KOLA | KAMEZ |
| 132 | DESTAN | SEJDI | DURAKU | KAMEZ |
| 133 | BASHKIM | RAKIP | SELAMI | PASKUQAN |
| 134 | ERMIRA | IBRAHIM | KORRA | PASKUQAN |
| 135 | HAQIF | ALUSH | KURTI | KAMEZ |
| 136 | SULLTAN | MUHARREM | MATA | PREZE |
| 137 | MISLIM JETMIR | HASAN | ISLAMI | PASKUQAN |
| 138 | ISMET | HYSEN | FEJZA | PASKUQAN |
| 139 | MAHMUT | SHABAN | SEFA | KAMEZ |
| 140 | HUMBE | QAMIL | NOKA | PASKUQAN |
| 141 | RAMIZ | ASLLAN | KULLI | PREZE |
| 142 | SURI | AGIM | RAMCI | KAMEZ |
| 143 | LIHE PAJIM | MYRTEZAN | ALIAJ | PASKUQAN |
| 144 | DASHAMIR | IBRAHIM | SALA | BULCESH |
| 145 | KAPLLAN | XHELAL | HYSA | KAMEZ |
| 146 | XHEVIT | IBRAHIM | PAJTONI | PREZE |
| 147 | XHEMAL FATOS | XHEMALI | PORJA | PASKUQAN |
| 148 | HAFUZ | RRAHMAN | LALA | PASKUQAN |
| 149 | LATIF | SHAQIR | DODA | PASKUQAN |

Mbi 800 barna do të mund të blihen nga qytetarët në farmaci pa "pyetur" mjekun

# Përfitimi i ilaçeve, shtohet lista e atyre që merren pa recetë

## Rimbursimi i barnave, përfitojnë rreth 475,000 qytetarë

Mbi 800 barna do të mund të blihen gjatë këtij viti nga qytetarët pa recetën e mjekut në farmaci. Për vitin 2018 është përditësuar lista e barnave OTC ose e thënë ndryshe e barnave pa recetë. Me përditësimin e saj kjo listë është pasuruar duke përfshirë më shumë se 800 lloje medikamentesh të cilat qytetarët mund t'i blejnë pa recetën e mjekut. Me zgjerimin e listës së medikamenteve OTC qytetarët mund të përfitojnë më shumë nga risitë që hidhen çdo ditë në treg. Në një kohë kur zgjerohet lista e medikamenteve pa recetë, pacientët shqiptarë ndeshin vështirësi në përfitimin e medikamenteve të shtrenjta me rimbursim. Fondi ka hartuar një sërë rregullash dhe kriteresh për të përfituar rimbursimin e medikamenteve të shtrenjta. Rregullat për të mbledhur pikët që kërkon fondi për rimbursimin e medikamenteve janë jashtë parametrave shëndetësore, kur flasim për kurim apo parandalim të sëmundjeve. Nëse i referohemi holluesit të gjakut Xarelto, në tregun farmaceutik shqiptar kushton 9500 lekë, ndërkohë që për ta marrë me rimbursim edhe pse mund të ta caktojë mjeku duhet që të kesh edhe dy diagnoza të tjera shtesë për të plotësuar pikët e kërkuara. Për të njëjtin medikament nëse bëjmë një krahasim me tregun farmaceutik të Kosovës, tregtohet me gjysmën e çmimit.



**BARNAT E RIMBURSUESHËM**

Lista e re e barnave të rimbursueshëm, e cila ka nisur të aplikohet zgjeron gamën e medikamenteve të rimbursuara si dhe diagnozave që mbulon, duke bërë të mundur që 475 mijë qytetarë të përfitojnë barnat me rimbursim. Drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Eduard Ahmeti deklaroi në muajin maj kur u miratuan edhe ndryshimet se lista e re përmban 1175 alternativa tregtare, 568 barna alternative të para dhe 244 principe aktive. "Në listën e vitit 2018 janë përfshirë 36 barna te reja për diagnoza si insuficencë kardiake, kancer, hepatit C, demence/alzheimer, diabet, etj. Këta barna, përmirësojnë dhe zgjerojnë trajtimin e pacientëve në shërbimet onkologjike, gastrohepatologjike, endokrinologjike, kardiologjike, psikiatrike, neurologjike etj. Padyshim risi është përfshirja në këtë listë e herceptinës, njëra formë e saj, e cila së bashku me formën tjetër që sigurohet në QSUT arrin mbulimin 100% të nevojave të grave dhe vajzave për trajtimin e kancerit të gjirit",-tha Ahmeti. Drejtori i Fondit deklaroi, gjithashtu, se është ulur çmimi i barnave krahasuar me listën e mëparshme: "Përveç shtimit të numrit të barnave të LBR 2018, vlen të theksohet se çmimet e miratuara janë ulur me rreth 11% krahasuar me çmimet e listës se mëparshme, duke sjellë kështu mundësinë për zgjerimin e listës së rimbursueshme dhe në përfshirjen e diagnozave të reja që më parë nuk ishin mbuluar", tha drejtori i FSDKSH. Ndërkohë krahas uljes së çmimit të barnave është rritur vlera e financimit për rimbursimin e barnave. FSDKSH financon rreth 10.4 miliardë lekë për rimburismin e barnave dhe përfitues janë rreth 475,000 qytetarë. Vetë m nga barnat e reja do të përfitojnë rreth 10 mijë qytetarë.




## PD, akuza për dëftesat me gabime, reagon ministrja: Shpifje të ulëta

Partia Demokratike denoncoi sot mospajisjen me dëftesa të nxënësve. Deputeti, Luçiano Boçi, deklaroi nga selia blu se pranë Partisë Demokratike dhe Komisionit të Edukimit dhe Mediave, kanë ardhur ankesa nga prindër, të cilët ngrenë shqetësimin se fëmijët e tyre nuk mund të pajisen dot me dëftesat e arsimit parauniversitar. Deputeti demokrat i bëri thirrje prokurorisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit të hetojnë, duke akuzuar ministren Nikolla, si të përfshirë në pazare. Të vetmet dëftesa që u printuan dhe u shpërndanë ishin ato të klasës së 9-të, tha ai, por edhe ato rezultuan me gabime, çka e bën dëftesën dokument të pavlefshëm për 35 mijë nxënës. Një pjesë prej tyre rrezikojnë të mos regjistrohen në shkollë të mesme brenda dhe jashtë vendit. Pas këtyre akuzave ka ardhur dhe reagimi i ministres së Arsimit Lindita Nikolla. Ajo shprehet se deri më tani nuk ka asnjë dëftesë me gabime apo pengesë për regjistrimin e nxënësve brenda apo jashtë vendit. Sipas saj, po vijon puna për plotësimin e dëftesës së lirimit, ndërsa thekson se janë plotësuar certifikatat dhe diplomat për maturantët. Nikolla sulmon Partinë Demokratike duke thënë se këto janë shpifje të ulëta që bëhen për qëllime politike.


REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

**PROCEDURE PROKURIMI**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Procedurë e veçantë sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 26.11.2014, i ndryshuar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 17.500.000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 03 Gusht 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.


### AKU bllokon 1 ton mish në Pogradec

## Tregtohej në kushte të këqija higjieno-sanitare dhe pa kontroll veterinar

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vijon aksionet për sigurinë ushqimore nëpër thertore, duke konfiskuar kësaj radhe në Pogradec gati 1 ton mish viçi dhe lope, i cili tregtohej në kushteve të rënda higjieno-sanitare. Mësohet se subjekti nuk kishte asnjë dokumentacion për kontrollet veterinare dhe sigurinë e produktit. Aksioni u zhvillua gjatë orëve të para të mëngjesit në një ambient të paregjistruar, ku shtetasi I.M u kap në flagrancë duke kryer therje të jashtëligjshme. Produkteve të bllokuara, 9 karkasa viçi me



peshë 655 kg, një karkasë lope me peshë 205 kg si dhe 35 kg të brendshme u mungonte dokumentacioni shoqërues, vula veterinare, kuponi tatimor etj. Krahas bllokimit të produktit, AKU mori edhe masën administrative me gjobë prej 500 mijë lekësh, si dhe ndalimin e menjëhershëm të aktivitetit. AKU u bën thirrje konsumatorëve të jenë të kujdesshëm në blerjen e produkteve shtazore, duke kërkuar informacione në pikat e shitjes së mishit, që të jetë i vulosur, të jetë i shoqëruar me certifikatë veterinare dhe kuponin tatimor. Më herët gjatë muajit korrik, AKU bllokoi dy kontejnerë me 50.2 tonë mish me origjinë nga Brazili, për shkak se mostrat u konstatuan me prezencë të salmonelës.



Kolazh me foto të veprimtarisë së kineastit Ilia Terpini

# Shuhet Ilia Terpini, kineasti që zbuloi Yllka Mujon e Matilda Makoçin

*Dashnori i përjetshëm i së bukurës ndërron jetë në Paris*

*Sa herë më pyesin për moshën them jam 35 vjeç. Sa keq që sot e morën vesh të vërtetën. Por unë nuk ndalem, kam ende shumë punë për të bërë".*

I njohur për rininë e përhershme në shpirt, ai që mendohej se do të ishte i pavdekshëm, kur e shihje me kamerën në sup, në çdo aktivitet, dje u shua në Paris.

Ka ndërruar jetë në moshën 82-vjeçare mjeshtri i madh i artit, kineasti i mirënjohur Ilia Terpini. Operatori i filmave Ilia Tërpini e ka nisur punën nga Kinostudio në vitet e arta të saj. Ka qenë drejtor fotografie i mbi 100 dokumentarëve e 26 filmave artistikë. Një ndër filmat e parë që ka realizuar me regjisorin Viktor Gjika ka qenë "I teti në bronz". Për punën e palodhur të tij mban titullin "Artist i merituar", është dekoruar me "Medaljen e punës" me "Çmimin e Republikës" është vlerësuar me medalje në 6 festivale të filmit, është vlerësuar me çmim kombëtar për fotografinë artistike dhe mban



*Në foto:*
**Kineasti Ilia Terpini**

Urdhrin "Mjeshtër i madh". Lajmin e dha miku i tij, kineasti Kujtim Gjonaj. "Sot m'u largua një mik i mirë!", shkroi ai duke rrëfyer se e mësoi nga një telefonatë e Zhani Terpinit, djali të mikut të tij gati gjysmë shekulli. "Ilia Terpini na la. Kishte shkuar në Paris për një kontroll rutine dhe Parisi i artit dhe kulturës, e mori në gjirin e tij artistin e madh. Sot, atje në qytetin e ëndrrave artistike, pushoi së rrahuri zemra e një njeriu të madh, e një miku të mirë, e një bashkëpunëtori dhe kolegu të aftë, e një artisti të shquar, që zor se mund t'i afrohet përkushtimit të tij ndonjë kineast tjetër",-shkroi Gjonaj në profilin e tij në Facebook. "U shua Ilia Terpini, njeriu që ia përkushtoi tërë jetën, deri në sekondat e fundit, artit më të ri, por nga më të dashurit, artit filmik. Kinemaja shqiptare humbi një ndër artistët e saj më të shquar, familja njeriun e dashur, ne miqtë dhe kolegët e tij njeriun e apasionuar dhe të papërtuar. Lamtumirë miku dhe bashkëpunëtori im i afërt Ilia. Dashuria jote për artin, ishte aq e madhe, sa dhe shpirti të fluturoi në qiell mbi qytetin e madh të artit, Paris!" e mbyllte ai postimin e tij. Për Mevlan Shanajn, ka ikur dashnori i përjetshëm i së bukurës. "Lajm i hidhur. Ikja e Ilia Terpinit është jo vetëm prekës e i dhimbshëm, por krijon një zbrazëti kombëtare. Ishte jo vetëm mjeshtër i kamerës, dashnor i përjetshëm i së bukurës. I mbetem mirënjohës për gjithë jetën, mësuesit, mikut, bashkëpunëtorit të pakrahasueshëm. Një shkrehje e aparatit të tij, më ka hapur rrugën e ekranit. Pas asaj foto u thirra për kinoprovë në filmin 'I teti në bronz'. Kamera e Terpinit do mbetet legjendë në ekranin e filmit shqiptar. Lamtumirë, mik i të gjithëve"-shkruante Mevlan Shanaj. Terpini, që ka realizuar 27 filma artistike dhe mbi 150 filma dokumentarë mbahet mend edhe për zbulimin e shumë aktorëve që më pas u bënë emra të njohur të ekranit.

"Në fakt, me Yllkën ishte krejt rastësi. Kishte nisur kërkimi për një rol të vogël, atë të Almës, vajzës së doktorit te filmi "I teti në bronz". Shëtita nëpër disa gjimnaze të Tiranës dhe fotografova rreth 60 vajza të reja për të përzgjedhur. Ndërsa aktorja Matilda Makoçi e kishte kaluar provën e parë, kur operatori Ilia Tërpini e zgjodhi për filmin "Si gjithë të tjerët", megjithatë edhe pse ishte hera e dytë, përzgjedhja ishte e rastësishme dhe kinoprova duhet të bëhej, në çdo rast… "Po përgatisnim filmin 'Si gjithë të tjerët' dhe po kërkonim nëpër shkolla për personazhin e Jetës. Matilda Makoçin e kam gjetur në Politeknikum"-kujtonte ai. "Tek filmi 'Në pyjet më borë ka jetë', mua më ra në dorë skenari i filmit 'Ballë për ballë'. Ishte shumë interesant si temë: atdheu, nëndetëset, avionët, anijet. Mendova që do të jetë fat i madh për operatorin që do të jetë caktuar për këtë film. Kur kthehem në Tiranë më thërret drejtori dhe më thotë, se ti je caktuar për filmin 'Ballë për ballë'. E kam xhiruar me kënaqësi atë film sepse të krijonte mundësi shumë të mira për kamera, etj. Film tjetër që unë e kam pasur shumë për zemër është dhe filmi 'Dimri i Fundit', që u xhirua në minus 17 gradë në Dardhë të Korçës. Tërë ditën rrinim jashtë dhe meqë ishim larg Tirane organizonim nga një mbrëmje kërcimi, që në atë kohës ishin pak të ndaluara, por kemi bërë gjëra të bukura", shprehej në një intervistë Ilia. Ndër filmat e 'Artistit të merituar' përmendim: 'I teti në bronz', 'Mësonjëtorja', 'Dimri i fundit', 'Të paftuarit', 'Flutura në kabinën time', 'Kapedani', 'Kush vdes në këmbë', 'Gunat mbi tela', 'Ballë për ballë', 'Muri i gjallë', si dhe një numër i madh dokumentarësh.

**TEATRI**

## BUJAR ASQERIU: BOLL ME PROTESTA POLITIKE, NUK MË PËRDOR AS PS DHE AS PD. DUA NJË TEATËR TË RI

**TIRANE -** Aktori i mirënjohur Bujar Asqeriu sqaron pozicionin e tij përfundimisht në lidhje me çështjen e teatrit. Ai nuk është më pjesë e aleancës për të cilën fliste sot regjisori Altin Basha për gazetën "Panorama", ku disa aktorë po përdoren për qëllime politike nga PD. Asqeriu ka një qëndrim të ekuilibruar për teatrin. Në një rrëfim për mediat dominon argumenti kryesor se për godinën e teatrit duhet të vendosin arkitektët dhe siç thotë ai, është një godinë që u ka marrë jetën shokëve të tij dhe ai vetë i duket sikur po sëmuret nga dita në ditë. "Nuk më përdor as PS dhe as PD". "E prita me shumë emocion ditën e enjte kur parlamenti votoi për ligjin për teatrin. Sigurisht thellë në vetëdijen time, e mendova që ai ligj do të aprovohej dhe më ra si bombë e m'u mbushën sytë me lot kur ai ligj kaloi në parlament, dhe nuk dua të mendoj e nuk dua që deputetët e mazhorancës të jenë pa integritet dhe të ngrenë kartonin me urdhër partie. Jo vetëm Majko, por unë prisja edhe disa deputete tjerë të ishin kundër këtij vendimi. Kjo nuk ndodhi dhe jemi para një fakti kur mazhoranca ka votuar për ligjin dhe mendova në moment që shefi opozitës, sipas mendimit tim gjithmonë, nuk kishte nevojë të bënte debat. Nëse ligji do të quhej antikushtetues, shefi i opozitës mund të thoshte vetëm dy fjalë: "Ju mund ta aprovoni këtë ligj që është antikushtetues, por nesër kur ne të vijmë në pushtet, do të nxjerrim një ligj për ta zhbërë ligjin tuaj, i cili është antikushtetues sipas nesh dhe çfarëdo që të ndërtohet sipas këtij ligji në territorin e teatrit apo dhe në sipërfaqet përreth, do të sekuestrohet sipas ligjit" dhe mbaronte historia. Së dyti, unë jam për unitetin dhe paqen sociale, nuk e mbështes protestën që bëhet tani. S'ka më sens! Logjika më e thjeshtë është që artistët të mendojnë ndryshe. Një pjesë thanë të shembet, një pjesë të qëndrojë dhe më ka ardhur keq jo vetëm nga qytetarët, por edhe nga kolegët e mi që po mundohen të zhbirojnë në jetët tona elemente biografikë. Kjo tregon një shkallë të ulët të civilizimit dhe cenimit të lirisë. Zotëri, ti s'më pengon mua që të kem një mendim sot dhe nesër të mos kem një tjetër. Zotëri, ti s'më pengon mua që të mbaj mendimet të ngrira. Konkurrenca e argumenteve duhet të jetë prioritet dhe në këtë rast fiton mendimi pozitiv dhe më i përparuar. Jam dakord dhe gjithmonë nëse qeveria do ma garantojë që brenda territorit të teatrit nuk do ndërtohet asnjë kullë. Në rast se fiton me argumente gjithmonë mosshembja e teatrit, ai duhet të rikonstruktohet që nga themelet, sepse nuk ka asnjë parametër që t'i qëndrojë e mund të zhvillohet aktivitet artistik. Këtë le ta thonë specialistët. Kam shpresë vetëm tek arkitektët. Nuk jam për protesta, nuk i mbështes. Dua të dëgjohen arkitektët. Unë më në atë godinë nuk futem më, sepse është sëmundje. E kam thënë gjithmonë dhe nuk pranoj. Dua të ngre edhe një herë zërin me forcë duke i kujtuar edhe një herë qeverisë shqiptare të kthejë vëmendjen në mënyrë serioze ndaj artistëve, që nga ligji për teatrin e nga statusi për ta, për godinat mendojnë arkitektët. Ne duhet të merremi me të drejtat tona. Nga ajo godinë që vdiqën shokët e mi, më duket se jam sëmurë edhe unë. Jam për paqe sociale dhe mua s'më përdor dot as PD e as PS. Dua një teatër të ri dhe nuk ka më kuptim që të vihemi kundër njëri-tjetrit, por t'ua lëmë këtë çështje arkitektëve. Boll se u teprua!", sqaron Asqeriu.

*(BalkanWeb)*

# BLUE TOOTH

Thashetheme

MADE IN ALBANIA

Nr. 618

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: **Pamela ALIAJ** - Art Designer: **Nevila Samarxhi**

E shtunë 14 Korrik 2018


# ANISA MUKAJ:

## Kur ëndrrat bëhen realitet





*Flet ish-misi shqiptar: Ju rrëfej vështirësitë e jetës së një modeleje. Jeta është e mbushur me zhgënjime, duhet punë dhe fat për të arritur atje ku dëshiron*



# ERIDA BAJRAKUTAJ:

## Ja kush e fiton Botërorin



## PROVOKON SËRISH ENCA HAXHIA, “BËJ TATTOO FUNDSHPINËN”







## Rrëfehet futbollistja: Ju tregoj lojtarin tim të preferuar

# Nesër finalja e kupës së botës, ERIDA BAJRAKUTAJ: Ja kush e fiton Botërorin

***Vetëm një ditë na ndan nga finalja e kupës së botës. Shumë prej nesh e kanë ndjekur me shumë kërshëri dhe kuriozitet lojën e bërë nga skuadrat e vendeve të ndryshme të botës duke bërë tifo për skuadrën e zemrës. Të dielën do të mbyllet sipari i kësaj loje botërore duke shpallur vetëm një fitues, por kush do të jetë ai? Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" ne kemi zgjedhur një nga vajzat më të lakuara dhe të vlerësuara të futbollit shqiptar, Erida Bajrakutaj, e cila ka folur për përshtypjet e saj lidhur me këtë botëror. Emocione, zhgënjime, por, gjithashtu, edhe shpresa për një fitore të merituar janë pjesë e kësaj interviste me futbollisten bukuroshe. Por kush do ta fitojë kupën e botës sipas Eridës? Për më tepër në intervistën e mëposhtme:***




*"Do të luaja me Gjermaninë për të takuar Manuel Neuer"*

# Ana "djeg" sërish "Instagram"-in, poston foto provokuese toples

Nuk është hera e parë që aktorja e njohur, Ana Lika poston foto me mbishkrime në "Instagram", që janë mjaftueshëm provokuese. Pas fotos toples në ballkon, një tjetër foto provokuese pason tani në faqen e saj në "Instagram". "Nxirja do të zhduket, por kujtimet do të mbeten përgjithmonë", shkruan aktorja në një nga fotot. Edhe pse bust, me buzët e kuqe dhe me cigare në gojë, ajo duket tepër joshëse dhe provokuese. Të shohim cili do të jetë provokimi i radhës!







# Provokon sërish Enca Haxhia, "Bëj tattoo fundshpinën"

Ajo është padyshim mbretëresha e provokimeve dhe fotove hot në "Instagram". Mesa duket, këngëtares se njohur, Enca Haxhia i pëlqen të luajë me pjesët e saj të trupit, duke provokuar me video që i poston në "Instastory". "Duke bërë tattoo fundshpinën", shkruan në anglisht në një nga videot e fundit të postuara. Në video duket shoqja e saj, që është duke i pikturuar në fundshpinë disa gjëra të pakuptueshme, ndërkohë që në video nuk shfaqet e plotë pamja. E çfarë tjetër ka ngelur pa bërë Enca?



Pamela Aliaj



**Jeni një nga vajzat më të talentuara dhe të vlerësuara të futbollit dhe me siguri e ke ndjekur me sy kritik botërorin. Me cilën nga skuadrat bënit tifo? Pse?**

Unë bëj tifo me Gjermaninë. Jam tifoze gjermane, por nuk më kënaqi fare këtë vit loja e tyre. Ishte shumë skadal! Arsyeja pse jam shkodrane-gjermane (qesh) është, sepse babi është tifoz gjerman dhe unë që e vogël kam qenë me Gjermaninë.

**Tashmë i erdhi fundi botërorit e të dielën është finalja e madhe. Kush mendoni se do ta fitojë kupën dhe pse?**

Franca ka një ekip shumë të mirë. Lojtarë të rinj, të talenturar e me shumë eksperiencë, por dhe Kroacia duhet të vlerësohet për karakterin e saj të lojës. Aty luajnë të gjithë bashkë, të gjithë që të fitojnë. Unë kam shumë dëshirë që të fitojë Kroacia.

**Cila ishte për Eridën ndeshja më e bukur e botërorit?**

Më pëlqeu ndeshja Gjermani-Suedi. Kur Gjermania shënoi golin në sekondën e fundit, jam gëzuar jashtë mase.

**Kush e meriton sipas jush "Topin e Artë"?**

Në qoftë se fiton kupën e botës, mendoj se Modric.

**Po lojtari juaj i preferuar, cili është?**

Lojtari im i preferuar është Manuel Neuer. Është portieri më i mirë në botë për mendimin tim, sepse ai e ndihmon shumë edhe skuadrën e tij

**Me cilën skuadër do të donit të luanit në botëror?**

Me Gjermaninë, sepse dua të takoj Manuel Neuer. (qesh)

**Pas botërorit kalojmë tek relaksi. Jeni me pushime dhe duke shijuar detin dhe diellin e kësaj vere të nxehtë. Cili është vendi i preferuar i Eridës për këtë verë?**

Se di, s'kam ndonjë vend të preferuar, sepse po shëtis çdo vend pak nga pak.

## Flet ish-misi shqiptar: Ju rrëfej vështirësitë e jetës së një modeleje

## U BË PJESË E MODELINGUT NDËRKOMBËTAR,



Ajo është një nga vajzat më të bukura të Shqipërisë, e cila arriti pas shumë përpjekjesh të realizojë ëndrrën e saj. Anisa Mukaj, ish-misi shqiptar tashmë është pjesë e kastit të modeleve ndërkombëtare në Stamboll të Turqisë. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", modelja na rrëfen prapaskenat dhe gjithë vështirësitë e jetës së një modeleje. "Të jesh modele nuk është e lehtë, është e mbushur edhe me zhgënjime...Por unë ndjehem mirë pasi ëndrrat e mija po fillojnë të prekin realitetin dhe të bëhen të prekshme," thotë Anisa. Për më tepër në intervistën e mëposhtme:

# ANISA MUKAJ: Kur ëndrrat bëhen realitet

*"Jeta është e mbushur me zhgënjime, duhet punë dhe fat për të arritur atje ku dëshiron"*

Pamela Aliaj

**Keni nisur karrierën prej pak kohësh si modele ndërkombëtare. Si ndihet tani Anisa?**

Po është e vërtetë që kam provuar vetveten si modele në Turqi. Ndjehem shumë e lumtur që zgjodha pikërisht këtë vend pasi është tepër i madh dhe mund të të ofrojë shumë në aspektin e modelingut. Ndjehem mirë pasi ëndrrat e mija po fillojnë të prekin realitetin dhe të bëhen të prekshme.

**Sa e vështirë është jeta e një modeleje?**

Jeta e një modeleje është e vështirë, sidomos në hapat e parë. Kërkon përkushtim, impenjim të madh dhe përpjekje të vazhdueshme. Nuk është aq e lehtë sa mund të duket në pamje të parë. Është sa e vështirë aq edhe e bukur, me plot të papritura dhe surpriza befasuese.

**Nga çfarë ka hequr dorë Anisa për të zgjedhur këtë rrugë?**

Modelingu ka qenë një dëshirë imja e hershme, dhe tani e konsideroj si një












arritje të diçkaje që më ka shoqëruar gjithmonë. Kur ndjek ëndrrat nuk besoj se mund të heqësh dorë nga diçka tjetër. Momentalisht po jetoj rrjedhën e gjërave të bukura pa m'u dashur që të heq dorë nga asgjë sado e vogël.

**Prej pak kohësh jeni pjesë e kastit të modelingut në Stamboll. Si ndiheni aty?**

Ndjehem shumë e lumtur dhe me fat që jam pjesë e kastit të modelingut në Stamboll. Është një vend që e dua katërçipërisht. Në të ia vlen për t'u përpjekur si dhe për të punuar fort. Dua mënyrën se si punojnë njerëzit atje, traditat, kulturën, gjithçka.

**Çfarë nuk prisnit nga ato që keni hasur në jetën e përditshme të një modeleje?**

Siç e thashë dhe më parë, jeta e një modeleje mund të duket perfekte. Po ashtu si çdo punë tjetër, edhe ajo të përball me vështirësi të ndryshme. Fillimisht të duhet të përshtatesh me jetën prej modeleje në tërësi. Duhet të ushqehesh si modele, duhet të rendësh që në mëngjes sipas axhendës së parapërgatitur, duhet të përshtatesh me jetën në grup, me njerëz të kulturave të ndryshme. Por të gjitha këto mendoj se ia vlejnë pasi të përgatisin për jetën, të bëjnë më të fortë dhe më të aftë për të përballuar jetën e vetme.

**Mbani mend ndonjë keqkuptim apo incident të ndodhur në ndonjë kast të bërë?**

Unë si natyrë jam tepër miqësore, komunikuese si dhe tolerante. Këto tri veçori nuk kanë lejuar që të bie pre e episodeve të ndryshme të pakëndshme. Mendoj që nuk më është dashur të ruhem, pasi thjesht mënyra se si unë jam e gatuar nuk ka lejuar të ndodhë asnjë incident i padëshiruar.

**Si është të jetosh me disa modele në një shtëpi? Me kë je e lidhur më tepër?**

Jetesa me disa modele në të njëjtën shtëpi në fillim nuk është e lehtë. Por po të gjesh një gjuhë të përbashkët, të mundohesh të përshtatesh dhe të tregohesh sadopak tolerante, gjithçka shkon mirë. Janë njerëz që ndan përditshmërinë, të njëjtat objektiva ndaj me kalimin e kohës natyrshëm të hyn në zemër dhe ambientohesh me zakonet dhe mënyrën e sjelljes së tyre. Më tepër kam bërë miqësi me një modele spanjolle me të cilën gjeta vetveten menjëherë, ndaj shpresoj ta ruaj miqësinë me të edhe në vazhdimësi.





**Si është një ditë e zakonshme e një modeleje në Stamboll?**

Dita e zakonshme e një modeleje në Stamboll fillon me të ngriturin herët në mëngjes dhe drejtimin për në destinacionet e përcaktuara. Përmban në vetvete tension dhe plot aventura. Si është një ditë nuk është një tjetër. Gjatë kohës së punës mund të serviren gjëra të pamenduara, të paparashikuara, por edhe zhgënjime, ndaj jeta e një modeleje është një surprizë e vërtetë. Të duhet shumë punë, por edhe tepër fat për të arritur atje ku dëshiron.

**Cila ka qenë kënaqësia më e madhe në jetën si modele që mbani mend?**

Kënaqësia më e madhe si modele i përket veprimtarive të fundit në Stambollin e bukur. Kam arritur disa gjëra pozitive, të cilat shpresoj të rriten dhe zhvillohen në të ardhmen.

**Ku ka qenë pagesa më e mirë që keni marrë dhe sa ka arritur vlera?**

Kur bëhet fjalë për punë që lindin nga ëndrrat besoj se nuk ngjall aspak interes për të folur për vlerat e pagës. Një punë e bërë me dëshirë dhe pasion të jep një kënaqësi shpirtërore të jashtëzakonshme dhe përpara një sadisfaksioni shpirtëror nuk vlejnë aspak pagesat.

**A do të ketë pushime këtë vit për Anisën?**

Për sa u përket pushimeve jam në planifikim e sipër. Preferoj së tepërmi jugun e Shqipërisë, por pse jo dhe të largohem për disa ditë edhe jashtë kufijve.

**Cili është vendi i preferuar ku do të donit të ishit pjesë e kastit të modeleve? Ku aspiron Anisa?**

Vendi i preferuar ku do të doja të isha pjesë e kastit të modeleve është Meksika. Aspiroj fushën e modelingut në Dubai dhe shpresoj të bëhem një ditë pjesë e asaj bote.






# Rrëfehen VIP-at, ja të pathënat e tyre







## FJORI HALILI: Nuk ta them dot në flas me Olsi Klosin

Ish-banorja e “Big Brother 9” pas një zhurme shumë të madhe që bëri nga ndarja me Olsi Klosin, mesa duket ka pranuar t’u përgjigjet pyetjeve të ndjekësve të saj lidhur me të. Edhe pse 99% e pyetjeve kishte lidhje me ata të dy dhe shumë prej ndjekësve dyshonin se Fjori kishte një lidhje sekrete me të, ose me menaxherin e VIP-ave, Xhani Demikën, ajo ua mbylli gojën të gjithëve me përgjigjet në “Instastory”. Të jenë provokime apo të vërteta?

## VESA LUMA: Liani vogëlush model? Jemi duke e menduar

Ata janë shkëputur prej kohësh nga vendlindja e tyre për një jetë akoma më të mirë në anën tjetër të botës, në Zelandën e Re. Por mesa duket, çifti do të rikthehet së shpejti me projekte të reja në Shqipëri dhe Kosovë. Ndërkohë që një gjë tjetër që u ka rënë në sy të gjithëve është Liani i vogël i Vesa Lumës dhe Big Bastës. Agjenci të ndryshme modelingu e kanë kërkuar si një model të vogël dhe prindërit këngëtarë janë duke e menduar. E pse jo? Një tjetër talent i familjes së tyre të bukur!




# Rroftë “Instagram”-i, njerëzit e

Nga Pamela Aliaj

***Mesa duket, mbase mund t’u themi ‘stop’ intervistave me VIP-at tanë për një farë kohe, sepse një nga rrjetet më të përdorura sociale po e bën punën tonë më të lehtë. Është vetë aplikacioni i “Instagram”-it, ai që së fundmi ka nxjerrë një opsion në “Instastory”, ku të gjithë njerëzit kanë mundësi t’i bëjnë një pyetje çdokujt për të shuar kuriozitetin e tyre. Mesa duket, një gjë të tillë e kanë mirëpritur edhe VIP-at tanë, të cilët kanë pranuar t’u përgjigjen pyetjeve me ‘spec’ të ndjekësve, duke mos pasur mundësi edhe t’i postojnë sërish ato në “Instastory”, duke bërë publike shumë nga të pathënat e tyre. Më poshtë kemi renditur disa më pikantet të këtyre dy ditëve të fundit.***




## FLORIANA GARO: Shumë shpejt do të kthehem në Shqipëri

Edhe pse prej kohësh tashmë është vendosur në Gjenevë së bashku me bashkëshortin dhe vogëlushen 4 muajshe, Floriana Garo ka dhënë një lajm shumë të mirë për ndjekësit e saj së fundmi. Nëpërmjet pyetjeve që i kanë bërë në “Instagram”, ajo ka rrëfyer se shumë shpejt do të kthehet në Shqipëri dhe se nëse dikush i bën një propozim joshës, do t’i rikthehet ekranit. Urojmë ta shohim sa më shpejt bukuroshen!




## ROZA LATI: Ja kur mendoj të martohem

Ajo është super e rezervuar për jetën e saj private dhe nuk parapëlqen të flasë asgjë lidhur me djalin me ‘tattoo’ që i ka rrëmbyer zemrën. Por kohët e fundit, moderatorja e “Why Not”, Roza Lati, pranoi t’i kthente përgjigje një nga pyetjeve të bëra nga ndjekësit e saj. “Kur do të martohem, të jem me fëmijë apo si ishte kjo pyetja?”, ka thënë Roza. Edhe kësaj radhe mbetëm pa përgjigje lidhur me planet e saj personale për të ardhmen. Privatësia mbetet e shenjtë!

# në rrjetet sociale







## FJORI DARDHA: Nuk kam marrëdhënie fare me Robert Aliajn

Mesa duket, ndjekësit e moderatores së "Boom", Fjori Dardha, nuk e kanë harruar ende debatin që kjo e fundit pati me një nga anëtarët e jurisë së "Dancing with me" në "Klan" TV kur ajo ishte konkurrente. Një nga ndjekësit e saj e ka pyetur se si i ka marrëdhëniet tani me Robert Aliajn dhe Fjori është përgjigjur: "Nuk kam pasur marrëdhënie fare, i vetmi komunikim ka qenë ai që keni parë edhe ju gjatë netëve të spektaklit". Pra, ende është e nderë marrëdhënia mes tyre dhe s'komunikojnë që atë natë. Një ngjarje që nuk ka pasur një zgjidhje pozitive si përfundim.

## ENCA HAXHIAJ: Ja cila është fobia ime më e madhe

Pas suksesit me këngën "Dua", këngëtarja Enca Haxhia po përgatitet që të nxjerrë shumë shpejt edhe dy projekte të tjera muzikore. Ndërkohë që nuk kishte se si të mos pranonte pyetjet e bëra nga ndjekësit e saj të shumtë në "Instagram". Ajo që ra më tepër në sy ishte fakti se Enca pranoi "t'i shfaqte" gjoksin njërit prej tyre në mënyrë komike, duke e vizatuar në "Instastory". Ndërkohë që një tjetër pyetje kishte lidhje me fobitë e këngëtares: "Më acarojnë hipokrizitë dhe kam fobi fluturat e zeza dhe energjinë e keqe". Kushedi se sa persona janë treguar hipokritë me këngëtaren duke e bërë atë që ta theksojë me shkronja të mëdha një fakt të tillë.






# njohur pranojnë të shfaqin "sekretet"







## ADELINA TAHIRI: Ja cili do të jetë emri i djalit

Ajo tashmë ka hyrë në muajin e 8 të shtatzënisë dhe shumë shpejt do të vijë në jetë vogëlushi i saj i parë. Adelina Tahiri zgjodhi të shkëputet nga muzika për një kohë të shkurtër, por shumë shpejt do t'i rikthehet asaj. Një gjë të tillë e ka bërë të ditur në "Instastory", duke thënë se bashkëshorti i saj maqedonas është i pari që ngulmon në rikthimin e saj në muzikë. Por nuk u ka shpëtuar as pyetjeve lidhur me emrin e vogëlushit që do të sjellë në jetë. "Do ta them kur të lindë", tha këngëtarja bukuroshe, por nuk ngurroi të tregonte shkronjën e parë. "J", ende nuk e dimë, por na mbetet të presim vetëm një muaj për ta zbuluar.

## AFËRDITA DRESHAJ: Kam bërë gjoksin! Burri bëhet xheloz për mua dhe Xhesika Berberin

Pas dasmës madhështore në Miami dhe muajit të mjaltit me hokeistin çek, Jakub Kindl, Afërdita i është kthyer rutinës së përditshme. Ajo ditët e fundit ka pasur kohë për ndjekësit e saj dhe ka pranuar t'u kthejë përgjigje disa prej tyre. Ndër pyetjet e bëra, ajo që ra më tepër në sy ishte ajo e faktit se modelja bukuroshe pranoi se kishte bërë ndërhyrje për zmadhimin e gjoksit. Gjithashtu, një tjetër pyetje interesante e cila u kalua në shaka ishte fakti se bashkëshorti i saj bëhej 'xheloz' për marrëdhënien e saj me një nga mikeshat më të ngushta, Xhesika Berberin. "Ka filluar të bëhet xheloz", ka thënë Afërdita.






Dje në 'Deutsche Welle'

# NATO dhe xhaxhai që nervozon

Nga Max Hofmann

*(vijon nga faqja 1)*

...tij, mendon Max Hofmann.

Shumë e kanë përjetuar një gjë të tillë, një xhaxha që nervozon kur shfaqet në çdo takim familjar dhe rrëfen gjatë gjithë ditës të njëjtën marrëzi. Ai si pjesëtar i familjes duhet të jetë i pranishëm në këto takime e askush nuk e merr më seriozisht atë. Por të tillë xhaxhallarë nuk kanë në dorë komandën jo vetëm ndaj arsenalit më të madh të armëve bërthamore, por edhe të ushtrisë më të fuqishme në botë. Ndaj, ndër shtetet e NATO-s nuk mund të jetë kaq e thjeshtë.

E megjithatë, Donald Trump tashmë ka arritur në atë të pikë sa të duket ndër partnerët e NATO-s ngjashëm si xhaxhai që nervozon. Si mund ta marrë atë psh., Gjermania seriozisht, kur ai në mëngjes prish gjakrat lidhur me blerjen e gazit në Rusi, pasdite pretendon se të dyja vendet kanë "marrëdhënie shumë, shumë të mira" dhe natën shkruan një "Tweet" me nota negative, për ta lëvduar më pas Gjermaninë në konferencën përmbyllëse. Kësaj i thonë si të japësh kulaçin e kërbaçin.

**GJITHMONË I NJËJTI AVAZ**

Veç kësaj, presidenti i SHBA-ve pothuajse gjithmonë i bie fyellit me një vrimë. Ai ndonëse zbulon aspekte të reja, kur është fjala për NATO-n, gjithmonë i mëshon parasë. Aleatët e tjerë duhet të paguajnë si duhet, përndryshe... E çfarë përndrysheë Këtë ai nuk dëshiron ta thotë, por rubla, 'sorry', dollari duhet të rrjedhë. Edhe pse të gjithë kanë nisur qysh më 2014, pra përpara se ai të bëhej president, t'i shtojnë në mënyrë të dukshme shpenzimet për mbrojtjen. Verbërisht Trumpi vazhdon me të njëjtin avaz. Kryeministrave si Angela Merkel nuk u mbetet tjetër veçse të sinjalizojnë: "Ne e kemi kuptuar këtë tani (e jemi duke bërë diçka)".

Të mos harrojmë këtu edhe të pavërtetat, që tregon ai për aktet e shpikura heroike të SHBA-ve: Kontributi financiar i SHBA-ve në NATO përbën 90%. 90 për qind të çfarëë Të buxhetit të NATO-së Në të kuota e SHBA-ve është pak më shumë se 20% dhe, edhe në rastin më të mirë nuk ka asnjë kategori brenda këtij buxheti, ku SHBA-të të mbulojnë të vetme 90 për qind. E kush do ta dëgjojë më këtë Uncle Sam në një sfond të tillëë E saktë, askush. E pikërisht kjo ka filluar të ndodhë tani në NATO.




Trumpit po i del boja. Nisur nga mesazhet e përsëritura të tij, partnerët e tjerë të NATO-s shumë shpejt nuk do ta dëgjojnë më atë. Sipas motos: Ne do të bëjmë çfarë të mundemi, nëse kjo nuk mjafton, atëherë largohu. Kjo do të thoshte fundi i aleancës, por Kanadaja dhe europianët nuk do të lejojnë të vihen pafundësisht nën presion prej Trumpit. Kësisoj presionit të presidentit të SHBA-ve do t'i humbiste efekti.

Edhe brenda vendit me sa po duket nuk po gjen më mbështetje kërcënimi i Donald Trump, se SHBA-të mund të veprojë e mëvetësishme. Sepse edhe ndër zgjedhësit kryesorë të tij, vende si Gjermania dhe Britania e Madhe konsiderohen si aleatët më të ngushtë. Vënia e NATO-s në pikëpyetje do t'i largonte prej tij shumë nga këta zgjedhës. Ndaj, Trump asnjëherë nuk flet për kuptimin ushtarak të aleancës, por vetëm për anën e biznesit. Në këtë fushë ai beson, qëndron dhe forca e tij. Dhe ankimi për "mos korrektesë" lë gjurmë tek zgjedhësit e tij.

**FATURËN DO TA PAGUAJNË SHBA-të**

Presidenti i SHBA-ve ka vetëm një armë në arsenalin e tij: deklarata të bujshme. Kjo mesa duket ka ndihmuar që partnerët e NATO-s të vihen në lëvizje duke i dhënë një përshpejtim rritjes së investimeve në ushtri. Por, për të ardhmen kjo nuk është fare e përshtatshme. Kjo shkatërron pikërisht atë që ai ndoshta synonte të inicionte. Partnerët e aleancës nuk do ta harrojnë këtë. Nëse pas disa vitesh ata do të jenë të pavarur nga pikëpamja ushtarake, ata do të kujtohen për këtë. Atëherë SHBA-të (ndoshta përsëri pa këtë president) do të ndiejë pasojat e reputacionit të humbur prej Trumpit.

Edhe nëse amerikanët e brohorasin presidentin në turin e tij shkatërrimtar: Nuk mund të jetë në interesin e vendit, ajo që bëri Trumpi në samitin e NATO-s në Bruksel. Shumica e qytetarëve në SHBA do ta regjistrojnë, që më së voni tani askush nuk i beson më presidentit të tyre. Dikur në një të ardhme të afërt, askush nuk do ta dëgjojë më atë. Njësoj si me xhaxhain që nervozon në festat familjare.



Fjalimi i Ditës

# Presidenti Meta vlerëson diplomatin Bashkim Zeneli "Mjeshtër i Madh"

*(vijon nga faqja 1)*

...Madh": "Në shenjë vlerësimi për kontributin e shquar dhe veprimtarinë e gjatë e të spikatur në fushën e politikës së jashtme ku, si gazetar, publicist, deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe ambasador, u ka shërbyer me përkushtim çështjes kombëtare e integrimit euroatlantik të Shqipërisë".

Në ceremoninë e dekorimit ishin të pranishëm përfaqësues të qeverisë, parlamentit, trupit diplomatik, pushtetit vendor, ish-ambasadorë si edhe personalitete të tjera të jetës publike në vend.

Presidenti Meta tha se kjo është ceremoni e veçantë pasi i kushtohet një personaliteti të njohur publik për të gjithë dhe një njeriu që me një pasion të jashtëzakonshëm dhe profesionalizëm të lartë edhe sot vijon pas pesë dekadash t'i përkushtohet dhe të kontribuojë për marrëdhëniet me jashtë të vendit tonë.

"Pak javë më parë, zoti Zeneli, kremtoi 70-vjetorin e lindjes dhe ky lajm motivoi shumë personalitete të kësaj fushe, por edhe mua si President për të iniciuar sot këtë ceremoni vlerësimi. Z. Zeneli i kreu studimet për drejtësi, por studimet pasuniversitare për gazetari dhe filozofi përcaktuan të ardhmen e tij duke iu dedikuar tërësisht marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikë së jashtme.

Ai e nisi si përkthyes i gjuhës gjermane dhe më pas si gazetar e analist i çështjeve të politikës së jashtme. Në vitin 1991 përfshihet në politikë si sekretar për marrëdhëniet me jashtë në Partinë Socialiste dhe për dy legjislatura zgjidhet deputet në Kuvendin Popullor. Si nënkryetar i Komisionit për Politikën e Jashtme të Kuvendit ka përfaqësuar Shqipërinë në veprimtari të shumta rajonale dhe ndërkombëtare, veçanërisht në kuadër të Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe OSBE-së", - tha Presidenti i Republikës, teksa theksoi në mënyrë të veçantë kontributin e veçantë dhe historik të zotit Zeneli pas viteve '90-të si politikan dhe si ambasador në mbështetje të luftës së Kosovës për liri.



"Ambasadori Bashkim Zeneli është një mjeshtër i diplomacisë publike. Për veprimtarinë gazetareske dhe politiko-diplomatike është nderuar me medalje dhe urdhra të shumtë. Ai është nderuar me tituj të ndryshëm dhe ka marrë vlerësime të shuma nga autoritetet e vendeve ku ka shërbyer si ambasador, si në Gjermani ashtu edhe në Greqi. Në ato vite që ambasadori Zeneli ka shërbyer në Gjermani mund të them se kriza e Kosovës dominonte marrëdhëniet me Gjermaninë dhe dihet roli dhe angazhimi gjerman për zgjidhjen e kësaj krize. Gjatë asaj periudhe, mbaj mend, janë kryer të gjitha vizitat e niveleve më të larta midis dy vendeve dhe njëkohësisht roli dhe angazhimi i Gjermanisë ka qenë i jashtëzakonshëm dhe Bashkim Zeneli nuk ka qenë vetëm ambasador i Shqipërisë, por ka qenë edhe ambasador i Kosovës jo të pavarur në atë kohë." - vijoi Presidenti Meta.

"Bashkim Zeneli në Gjermani është përfshirë për tri vite radhazi në "Enciklopedinë e figurave të shquara në Republikën Federale të Gjermanisë". Edhe në Greqi ambasadori Zeneli është nderuar si "Qytetar Nderi i Athinës" apo medaljen e artë 'Zgalemi i Lirisë' për kontributin e dhënë në integrimin e bashkatdhetarëve tanë atje, por padyshim edhe për forcimin e miqësisë midis shqiptarëve dhe grekëve.

Lista e vlerësimeve dhe e personaliteteve që kanë nderuar ambasadorin Zeneli është e gjatë dhe do të dëshiroja të sillja këtu si referencë vlerësimet e ish-Presidentit të Gjermanisë, Johannes Rau, i cili ndër të tjera shprehet se: 'Ju i keni ndryshuar imazhin vendit tuaj. Angazhimi i juaj në çështjen e Kosovës ishte pashembullt.... Shqipëria na ka respektuar shumë që na solli një ambasador si ju'. Po kështu duke vlerësuar marrëdhënien e veçantë të fqinjësisë së mirë dhe të partneritetit me Greqinë jam ndjerë jashtëzakonisht i lumtur se edhe ish-Presidenti i Greqisë, Karolos Papulias e vlerësonte ambasadorin Zeneli si diplomatin që kishte kontribuar për ngritjen e nivelit të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë në nivelin më të lartë që ato kishin pasur ndonjëherë dhe që i kishte dhënë një dimension human këtyre marrëdhënieve." - vuri në dukje Presidenti i Republikës.

Ndër të tjera, Presidenti Meta theksoi edhe bazat e përcaktimit dhe vlerësimit për këtë personalitet: "E para, përkushtim në një moment mjaft deciziv për çështjen e Kosovës ku rrezikohej të asgjësohej gjysma e kombit tonë për zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe puna e tij ka qenë e shkëlqyer, e jashtëzakonshme dhe e palodhur. Së dyti, orientimi euro-atlantik i zotit Zeneli ka qenë i qartë që në ditët e para të fillimit të transformimeve demokratike në Shqipëri".

Ndërsa, ambasadori Bashkim Zeneli në fjalën e rastit falënderoi Presidentin e Republikës për këtë nderim të lartë dhe u shpreh: "Ju Zoti President më nderuat me këtë titull të lartë nga pikëpamja profesionale dhe unë u jam shumë mirënjohës. Këtë titull të lartë e ndaj në radhë të parë me familjen time, u jam mirënjohës në këtë punë, pasi gazimi dhe lumturia marrin forcë e peshë vetëm kur ndahen. Asgjë nuk mbahet për vete. Kam luftuar dhe do të luftoj në çdo gjë për interes të vendit, atdheut dhe sot të duash atdheun, të jesh patriot do të thotë të punosh për të ardhmen pa shumë zhurmë, pa shumë bujë, pa i rënë gjoksit e pa bërtitur".

## HOROSKOPI

### DASHI
Do të jeni largpamës dhe të matur në sipërmarrjet tuaja, dhe do të keni zgjidhjet e duhura në kohën e duhur: Kështu nuk lejoni që t'ju shpëtojnë mundësitë e mira. Mundësitë janë të vogla për të bërë paqe me familjen, për faj të Marsit. Nëse filloni një debat, kush do të arrijë t'ju ndalë pastaj?

### DEMI
Do të jetë një ditë e mirë për ju, kjo e sotmja. Nëse jeni duke ndërmarrë një projekt të rëndësishëm në punë jepni maksimumin, por pa kompromentuar parimet tuaja. Pozicioni i Saturnit bën që mos ngatërroheni dhe të bëni gabime ne veprimtarinë tuaj.

### BINJAKET
Marsi më në fund pozicionohet përballë shenjës suaj: do të përjetoni një zjarr pasionant, pas një faze shumë kritike të kriuar nga disa tensione në familje. Keni shumë punë për të bërë si në shtëpi ashtu edhe në zyrë, dhe praktikisht nuk mbarojnë kurrë! Bëni më shumë veprimtari fizike.

### GAFORJA
Hëna mike kujdeset për jetën shoqërore, dhe në marrëdhënie të mirë me Uranin, garanton kështu miqësi të mira dhe së bashku me Saturnin, stabilizimin të marrëdhënieve. Në karrierë keni shumë ambicie, ëndërroni ndërmarrje të madha, por projektet tuaja ende nuk janë të përsosura.

### LUANI
Është një ditë pozitive për të përmbyllur marrëveshje fitimprurëse, por ndërkaq jo të të gjitha llojeve. Specialiteti juaj janë ato lloj marrëveshjes të shpejta dhe që nuk kërkojnë shumë angazhim. Një frymëmarrje çliruese në çift: sot do të shpëtoni nga Marsi i ashpër dhe nganjëherë i pakontrollueshëm.

### VIRGJERESHA
Hëna mike formon një marrëdhënie të shkëlqyer me Uranin si edhe me Saturnin që prej kohësh ndodhet në shenjën tuaj. Profesionalizmi juaj është i përsosur: do të tregoni seriozitet dhe përkushtim, dy elementë të domosdoshëm, si edhe mendjemprehtësi.

### PESHORJA
Çfarë dite! Tashmë Hëna ju bën të dëshironi të pamundurën, dhe për më tepër Marsin e keni kundra, duke shtuar një dozë të jashtëzakonshme xhelozie. Kështhillat e urta të miqve, edhe nëse në të fillim nuk do t'ju bindin, koha do të tregojë se do të kenë të drejtën.

### AKREPI
Sot më të mirën jua ofron Marsi: kjo është shtytja e duhur për të marrë përsëri rrugën e duhur, duke lënë pas çdo hezitim. Do të hapet një fazë e re ku do të jeni të gjallëruar nga ideale të reja dhe të inkurajuar nga njerëz që mendojnë si ju.

### SHIGJETARI
Për dashuri ende nuk bëhet fjalë, parapëlqeni të mbeteni tek miqësia, edhe pse nën sipërfaqen vloni nga pasioni... Tani për tani do të shijoni një ditë të mirë në nivel profesional, duke përfshirë ndërmarrje fitimprurëse dhe takime të frytshme.

### BRICJAPI
Mike e Jupiterit, Hëna do të mbizotërojë në shenjën tuaj, duke formuar një marrëdhënie të mirë me Saturnin dhe Uranin. Do të keni një përzierje të bukur të fatit, dinamizmit ritmik dhe urtësisë. Ndërkaq, Marsi do t'ju krijojë disa ndërlikime.

### UJORI
Një nisje e ngadaltë për një udhëtim kënaqësie. Do të jeni të qetë, dhe gjithçka do të kryhet, por do të duhet kohë, edhe pse nga natyra jeni shumë impulsiv! Përshëndetni udhëheqësin tuaj, Marsin, i cili sot del nga shenja juaj. Sot do të mbikëqyrni veprimtarinë tuaj financiare.

### PESHQIT
Është një ditë e rëndësishme për ju, me Marsin që hyn në shenjën tuaj, duke ju garantuar kështu një periudhë energjie të jashtëzakonshme, gjallërie dhe vendosmërie, qoftë në sporte si edhe në të gjitha aktivitetet që kërkojnë guxim dhe forcë fizike.

SULMUESI I FRANCËS

# Grizman do Kupën e Botës dhe thumbon Kurtuan



Antuan Grizman është një lider i vërtetë. Asnjë mani për protagonizëm nga ana e njeriut simbol, që së bashku me Mbapen e ka marrë përdore Francën në finale e Botërorit. Të gjithë flasin për të, por sulmuesi mbetet i përqendruar tek objektivi, ndonëse e diela është pranë. "Nuk e kam mendjen te 'Topi i Artë', kemi rastin tonë për të fituar Kupën e Botës dhe më intereson vetëm kjo. Nuk ka aspak rëndësi nëse shënoj, i rëndësishëm është objektivi final. Jemi një skuadër e madhe dhe duam t'ua japim këtë kënaqësi francezëve, tifozët tanë duhet të jenë krenarë që janë francezë". Grizman më pas ka replikuar me Kurtuan, portierin e Belgjikës, që pas humbjes në gjysmëfinale kundër Francës, i përcaktoi gjelat si ekip "anti-futboll". Përgjigja e numrit shtatë vjen e thatë dhe plot piper. "A e di ai se luan për Çelsin dhe jo për Barcelonën? Nuk na intereson sesi fitojmë, e rëndësishme është të fitojmë". Lojtari i Atletikos së Madridit, në Rusi është sakrifikuar shumë edhe gjatë fazës mbrojtëse, ndërsa tani përballë është Kroacia, që në mesfushë është e frikshme. "Mbrojtja është pika jonë më e fortë. Jemi të karikuar. Ata kanë lojtarë të mëdhenj si Modriç e Rakitiç, janë teknikisht shumë të fortë, por do të përgatitemi siç duhet për t'u përballur me ata. Simeone apo Deshamp? Të dyve u intereson e njëjta gjë, fitorja".

Presidenti i FIFA-s lavdëron organizimin e Rusisë dhe "përkëdhel" kabinetin e Putinit

# Infantino: Ky, Botërori më i mirë në histori

## *VAR-i risi pozitive, asnjë rast dopingu*

Jeton Selimi

Presidenti i FIFA-s, Xhani Infantino, është shend e verë për mënyrën sesi kanë shkuar gjërat në Rusi. Madje, nuk e mban sekret dhe e thotë për të gjithë tifozët nga salla e konferencave në "Luzhniki" të Moskës. "Prej disa vjetësh thoshim se ky Botëror do të ishte më i miri i historisë, ndërsa sot mund ta pohoj me bindje të plotë. 'Rusi 2018' është Botërori më i mirë i të gjitha kohërave". Sipas numrit një të qeverisë së futbollit botëror, meritë për këtë ka vendi organizator. "Perceptimi për Rusinë ka ndryshuar. Mijëra njerëz kanë vizituar shtetin gjatë Botërorit dhe kanë zbuluar një vend të bukur, mikpritës i pasur me histori dhe kulturë". Duke bërë një bilanc të turneut që po vjen drejt mbylljes me finale e madhe që do të luhet mes Francës dhe Kroacisë, Infantino ka falënderuar edhe qeverinë e Putinit. "Jo vetëm në Moska, por në të gjitha qytetet pritëse, vizitorët kanë shijuar ngrohtësinë dhe mikpritjen e popullit rus. Shumë paragjykime rreth vendit janë përgënjeshtruar falë këtij Botërori. Rusia ka ndryshuar, është bërë një vend futbolldashës, ku futbolli nuk është vetëm një Botëror, por tashmë është bërë pjesë e ADN-së vendit".





Frika më e madhe e këtij Botërori ishte çështja e dopingut, por edhe këtu Infantino lavdëron punën e mirë të bërë nga agjencitë. "Janë kryer mbi 2000 kontrolle antidoping përpara dhe gjatë Botërorit dhe mund t'ju them se asnjë rast prej tyre nuk ka rezultuar pozitiv. Ky është sukses". Në fund, dy fjalë edhe për VAR-in, një nga risitë e mëdha të këtij Botërori, që në këtë turne është përdorur shpesh. "VAR-i ka funksionuar. Rezultatet janë mëse të qarta dhe pozitive. VAR-i është përdorur në 440 raste, ndërsa 16 vendime të gabuara janë korrigjuar. VAR-i po pastron futbollin, duke e bërë më transparent dhe të ndershëm".

Finalja e vogël

# Suthgejt dhe Martinez duan trofeun ngushëllues

Gareth Suthgejt i kërkon Anglisë edhe një sforco tjetër karakteri për finalen e vendit të tretë kundër Belgjikës. Trajneri i "Tre Luanëve" ndjen keqardhje për eliminim nga Kroacia, por u kërkon lojtarëve edhe një përpjekje të fundit. "Jemi të motivuar, është një mundësi për të fituar një medalje në një Botëror, një arritje që vetëm një tjetër kombëtare angleze e ka bërë deri më sot. Kanë qenë dy ditë shumë të vështira për ne. Ishim 20 minuta larg finales, këtu ishim për atë. Por djemtë janë të mrekullueshëm dhe duan ta mbyllin me kokën lart turneun". Pavarësisht zhgënjimit për eliminimin në gjysmëfinale, Belgjika tregon krenari dhe dëshirë për fitore në finalen ngushëlluese kundër Anglisë, fjalë këto të thëna qartë nga trajneri Roberto Martinez. "Duam ta mbyllim Botërorin me një emocion pozitiv. Çdo tifoz belg meriton ndjesinë fituese në fund të turneut. Nuk ka më sekrete mes nesh dhe anglezëve. Do të luajnë shpejt si gjithmonë. Nuk pres surpriza. 'Këpuca e Artë'? Nuk ka interesojnë çmimet individuale dhe Romelu ka qenë i pari që e ka treguar këtë me mënyrën e tij të lojës. Ai është këtu për të ndihmuar skuadrën të fitojë. Ta mbyllësh Botërorin si vend i tretë, ka më shumë rëndësi se çfarëdolloj çmimi individual".

VËZHGIMI

# Tri arsyet se përse duhet të fitojë Kroacia

Finalja e madhe e "Rusi 2018" është në prag, me fituesen e vitit 1998, Francën, që do të përballet me Kroacinë në "Luzhniki" të Moskës, me ballkanasit që vijnë për herë të parë në një takim të këtij niveli. Pak përpara fillimit, le të shohim përse "të zjarrtët" meritojnë të ngrenë lart Kupën e Botës dhe të shkruajnë emrin në librat e historisë përgjithmonë. **E para, një kolektiv i mrekullueshëm dhe një motivim maksimal**

Trajneri i Kroacisë, Zllatko Daliç, ka bërë diçka të pabesueshme. Atmosfera në skuadër nuk ka qenë kurrë më e mirë dhe lojtarët e kanë përsëritur gjithmonë këtë. Ata janë shfaqur si një familje e vërtetë gjatë kësaj Kupe Bote, duke qenë se kanë qëndruar bashkë për 50 ditë. Lojtarët duket sikur janë të gatshëm të japin jetën për njëri-tjetrin me përpjekjet e mëdha që bëjnë. Ndonëse kanë luajtur tri ndeshje radhazi me kohë shtesë, ata kanë shfaqur një dëshirë të madhe për fitore dhe një kolektivitet të lartë.

**E dyta, forca mendore dhe karakteri**

Danimarka, Rusia dhe Anglia, me të tria këto skuadra, "të zjarrtët" kanë ardhur nga humbja për të fituar në shtesë ose me penallti. Përmbysjet e kroatëve kanë ardhur si shkak i forcës mendore dhe fizike. Kapiteni Luka Modriç e ka thënë shpesh fjalinë: "Kemi treguar karakter! Personaliteti i Kroacisë do të luajë një rol të madh kundër Francës. Gjatë historisë, çdo skuadër që ka fitur Kupën, ka treguar më shumë karakter se të tjerët.

**E treta, eksperienca është e barabartë me besimin te vetja**

Modriç është lideri i një gjenerate të madhe të futbollit kroat. Përveç xhevahirit të Real Madridit, ka edhe yje të tjerë në skuadrën e Daliçit, lojtarë nga Barcelona, Interi, Juventusi apo Liverpuli, si Ivan Rakitiç, Mario Manxukiç, Ivan Perisiç, Mateo Kovaçiç dhe Dejan Lovren. Me një mesatare moshe prej 27 vjeç e tetë muajsh, Kroacia ka shumë eksperiencë dhe vetëbesim sepse çdokush është titullar në klubin e tij. Të gjithë ata janë të bindur për forcën e tyre.

Më pak kartonë të kuq se kurrë

# Ky Botëror, tuneu i djemve të 'mirë'

Mbase është meritë e klasifikimit të fair-play, që dukej si një kërshëri e madhe, por që vendosi kalimin e grupit nga ana e Japonisë dhe jo të Senegalit, që në ndeshjet në grup ishte treguar më agresiv. Mbase sepse me prezencën e VAR-it, askush nuk e ka çuar ndërmend që të bëjë ndërhyrje të ashpra, duke qenë se gjyqtari mund t'i rikthehej pas në vendim për të gjitha rastet që ka dhënë kartonin e verdhë dhe të jepte të kuqin. Por sidoqoftë, rezultati është të para syve të të gjithëve. Ai i "Rusi 2018", është Botërori më i butë i 40 viteve të fundit. Për të gjetur një turne të tillë, duhet të shkojmë në Argjentinë '78, me vetëm 3 të kuq dhe 59 të verdhë. Në Rusi kartonët e verdhë kanë fluturuar pa të keq, 214 të tillë dhe dy finalet nuk janë luajtur ende. Një e dhënë në rritje krahasuar me Botërorin brazilian, ku në total pati 181 të verdhë, por nëse shohim kartonët e kuq, trendi është në rënie. Kartonët e kuq numërohet me gishtat e njërës dorë, katër në total, Sançez i Kolumbisë, Boateng i Gjermanisë, Smolnikov i Rusisë dhe Lang i Danimarkës. Shumë të kuq më pak sesa edicionin e shkuar, ku në total u ndëshkuan 10 lojtarë. Rekordin nga ky këndvështrim e mban Gjermani 2006, ku në 64 ndeshje fluturuan 28 kartonë të kuq, gati një i kuq çdo dy ndeshje. Mbeten finalet, ajo e madhja dhe e vogla, por nuk para ndodh që të këtë problem disiplinore nëpër finale. Në vitin 1990 Monzon e Dezoti thyen tabunë duke marrë dy të kuq në historinë e finaleve. Ndodhi edhe në vitin 1998, kur Desaji shkoi para të gjithëve në dushe. E kush e ka harruar vitin 2006? Gjuajtjen me kokë e Zidan ndaj Materacit, që tashmë është bërë edhe skulpturë. Në vitin 2010 Heitinga i la holandezët me 10 vetë në kohën shtesë, ndërsa Kupën e ngriti Spanja.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al